

**PËR NGRITJEN, PËRBËRJEN DHE MËNYRËN E FUNKSIONIMIT TË
KOMISIONIT TË PËRHERSHËM TË VLERËSIMIT TË OBJEKTEVE TË
TRASHËGIMISË KULTURORE, NË PRONËSI PRIVATE, TË LUAJTSHME DHE
PËR KRITERET SHKENCORE E PROCEDURAT E VLERËSIMIT TË KËTYRE
OBJEKTEVE**

VENDOSI:

I. KOMISIONI I PËRHERSHËM I VLERËSIMIT

- një specialist etnolog nga Instituti i Kulturës Popullore anëtar;
- një specialist organolog nga Instituti i Kulturës Popullore anëtar;
- një specialist arkeolog nga Instituti i Arkeologjisë anëtar;
- një studiues të artit mesjetar nga Instituti i Monumenteve të Kulturës anëtar;
- një studiues të artit pamor nga Galeria Kombëtare e Arteve anëtar;
- një studiues të arkitekturës nga Instituti i Monumenteve të Kulturës anëtar.

I. Komisioni ka për detyrë të vlerësojë objektet e trashëgimisë kulturore, në pronësi private, të luajtshme, që dalin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe t'i rekomandojë Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, që në mbështetje të aktvlerësimit të objekteve, të autorizojë ose jo nxjerrjen e tyre jashtë këtij territori.

- Mbledhjet e komisionit të përhershëm të vlerësimit zhvillohen në Qendrën Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore.

- Kryetari përcakton datën, orën, objektin dhe rendin e ditës, të cilat ua komunikon anëtarëve të komisionit.

- Kryetari, me kërkesë të subjektit të interesuar, person fizik ose juridik, drejtuar Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, por jo më vonë se 10 ditë nga depozitimi i kërkesës së të interesuarit, thërret mbledhjen për nxjerrjen jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të objekteve.

- Komisioni, pasi shqyrton kërkesën, harton aktvlerësimin e objekteve, dhe brenda 10 ditëve, ia dërgon atë së bashku me dokumentacionin përkatës Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

- Komisioni i merr vendimet me shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve.

II. KRITERET SHKENCORE TË VLERËSIMIT TË OBJEKTEVE

1. Anëtarët e komisionit, sipas fushave përkatëse, bëjnë vlerësimin e objekteve, sipas listës së katalogimit të objekteve të trashëgimisë kulturore, të miratuar nga Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore.

2. Çdo objekt i shënuar në formularin standard të aplikimit, pajiset me një numër të caktuar dhe një pasaportë identifikuese.

3. Objektet e trashëgimisë kulturore, në pronësi private, të luajtshme, që dalin jashtë territorit të vendit, duhet të regjistrohen në Qendrën Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore dhe të pajisen me pasaportën përkatëse të kësaj qendre.

III. PROCEDURAT E VLERËSIMIT DHE TË DHËNIES SË LEJES

1. Vlerësimi i objekteve të trashëgimisë kulturore, në pronësi private, të luajtshme, bëhet pas kërkesës me shkrim të subjektit të interesuar, person fizik ose juridik, drejtuar Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Kërkesa shoqërohet me:

a) kopjen e formularit standard të aplikimit, të plotësuar në Qendrën Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore;

b) pasaportën përkatëse për çdo objekt, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore;

c) për personat juridikë, dokumentacionin e plotë ligjor të regjistrimit si person juridik në gjykatë, organet tatimore dhe organe të tjera të specializuara, vërtetimet nga gjykata, prokuroria, përmbarimi dhe organet tatimore, që vërtetojnë se personi i interesuar nuk ka detyrime ndaj tyre, si dhe nuk është në proces gjyqësor, civil apo penal;

ç) për personat fizikë, fotokopjen e pasaportës dhe adresën e saktë të vendbanimit, si dhe vërtetimet nga gjykata, prokuroria, përmbarimi dhe organet tatimore, që vërtetojnë se personi i interesuar nuk ka detyrime ndaj tyre;

d) mandatpagesën përkatëse nga Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore, sipas numrit të objekteve që kërkohet të dalin jashtë vendit.

2. Kërkesa me shkrim, së bashku me dokumentacionin e mësipërm, kalon për shqyrtim dhe vlerësim në komisionin e përhershëm të vlerësimit.

3. Komisioni, pas shqyrtimit të dokumentacionit të plotë dhe vlerësimit fizik të objekteve, harton aktvlerësimin e objekteve që kërkohet të dalin jashtë territorit të vendit, në tri kopje, njëra për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, njëra për Qendrën Kombëtare të Inventarizimit të Pasurisë Kulturore dhe njëra për subjektin e

interesuar.

4. Aktivlerësimi përmban:

- a) Objektet që lejohen të dalin jashtë vendit, shoqëruar me numrin e pasaportës.
- b) Objektet që ndalohen të dalin jashtë vendit, shoqëruar me numrin e pasaportës.
- c) Mënyrën se si duhet të veprohet, për objektet që nuk lejohen të dalin jashtë vendit.

5. Komisioni, në bazë të aktivlerësimit të objekteve, vendos me shumicë votash dhe ia përcjell vendimin Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

6. Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, brenda 10 ditëve, vendos dhënien ose jo të lejes, për nxjerrjen jashtë territorit të vendit, të objekteve të trashëgimisë kulturore, në pronësi private, të luajtshme, sipas aktivlerësimit të komisionit të përhershëm të vlerësimit. Ndaj vendimit për mosdhënien e autorizimit të Ministrit mund të bëhet ankim, administrativ apo gjyqësor, sipas mënyrës dhe afateve të parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative dhe Kodin e Procedurës Civile.

7. Leja për nxjerrjen e objekteve jashtë territorit të vendit, e miratuar nga Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, i dërgohet subjektit të interesuar dhe, për dijeni, komisionit të përhershëm të vlerësimit dhe Qendrës Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore.

8. Subjekti i interesuar paguan këto tarifa:

a) Për aktivlerësimin e objekteve:

- 5 000 (pesë mijë) lekë kur numri i objekteve është më pak se 50.
- 10 000 (dhjetë mijë) lekë kur numri i objekteve është më shumë se 50.

b) Për çdo formular standard të aplikimit, të plotësuar pranë Qendrës Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore sipas lidhjes nr.1, 100 (njëqind) lekë.

IV. TË ARDHURAT DHE SHPËRBLIMI I ANËTARËVE TË KOMISIONIT

1. Të gjitha të ardhurat nga pagesat e tarifave të mësipërme, kalojnë në buxhetin e Qendrës Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore.

2. Anëtarët e komisionit të përhershëm të vlerësimit, për kontributin që japin, shpërblehen nga fondi që krijohet nga të ardhurat e mësipërme me 5000 (pesë mijë) lekë, secili për çdo aktivlerësim.

V. ZBATIMI

1. Ngarkohet Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, që brenda 10 ditëve nga hyrja në fuqi e vendimit, të miratojë emrat e anëtarëve të komisionit, të propozuar nga institucionet përkatëse.

2. Ngarkohen Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve dhe institucionet e specializuara shkencore për zbatimin e këtij vendimi.

VI. HYRJA NË FUQI.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
QENDRA KOMBËTARE E INVENTARIZIMIT TË PASURIVE KULTURORE

Formular standard i aplikimit

Nr.....dt...../.....2003

NR.	EMRI I OBJEKTIT	NR.PASAPORTËS	SASIA (copë/kopje)
1			
2			
3			
4			
5			
6			
7			
8			
9			
10			
11			
12			
13			
14			
15			
16			
17			
18			
19			
20			
21			
22			
23			
24			
25			
26			
27			

28			
29			
30			

Emri, Mbiemri dhe Firma e aplikantit

Adresa, Tel. & Fax, Mob

VENDIM
Nr.426, datë 13.7.2007

PËR MIRATIMIN E KARTËS SHQIPTARE TË RESTAURIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6 të nenit 17 të ligjit nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kartës shqiptare të restaurimit, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 2. Ngarkohen institucionet e specializuara, sipas ligjit nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, si dhe subjektet e licencuara për restaurimin e objekteve të trashëgimisë kulturore, për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

KARTA SHQIPTARE E RESTAURIMIT

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i udhëzimeve të shpallura në këtë dokument, të quajtur “Karta Shqiptare e Restaurimit”, është miratimi i kriterëve themelore në fushën e restaurimeve, për të plotësuar dhe më tej zëvendësuar “Kartën Shqiptare të Restaurimit”, të vitit 1986 dhe për të kryer punimet e restaurimit sipas rregullave të përcaktuara në këtë kartë.

Neni 2
Objekti

Objekt i kësaj karte janë vlerat e trashëgimisë kulturore, të çdo kohe, që nga monumentet arkitektonike, deri tek piktura dhe skulptura, si dhe që nga gjetjet e kohës paleolitike e deri tek

shprehjet figurative të kulturave popullore, etnografike, të artit bashkëkohor, të librave dhe dokumenteve arkivore, dëshmi të zakoneve e traditave, objekte këto që i përkasin personave fizikë, juridikë, privatë apo publikë, me qëllim mbrojtjen konservimin dhe restaurimin e tyre.

Përveç objekteve të përmendura më sipër, sigurojnë mbrojtje dhe restaurim, të gjitha vlerat materiale të trashëgimisë kulturore në përputhje me parashikimin e Nenit 4, paragrafi I, pika 1 dhe 2 të ligjit 9048, dt. 07.04.2003 "Për trashëgiminë kulturore" të ndryshuar.

Bëjnë pjesë në disiplinën e rregullave të Kartës Shqiptare të Restaurimit, edhe veprimet e kryera në funksion të sigurimit të mbrojtjes dhe restaurimit të mbetjeve arkeologjike, tokësore dhe nënujore.

Neni 3

Shpjegim i terminologjisë

"Konservim" janë të gjitha masat e ndërmarra që nuk kërkojnë ndërhyrje direkte në vepër siç janë krijimi i kushteve mjedisore (lagështi relative, temperaturë, pastërti nga ndotja atmosferike, mbrojtja nga pluhurat, dëmtimi biologjik dhe fizik në fonde, ekspozimi dhe transporti), si edhe ndërhyrjet kimike direkt në objekt apo vepër, me qëllim parandalimin e çdo lloj dëmtimi.

"Ndërhyrje" është tërësia e masave të ndërmarra dhe operacioneve të kryera në vepër, me qëllim ndalimin e degradimit të mëtejshëm dhe nxjerrjen në pah të vlerave të saj.

"Restaurimi" është vlerësimi i thelbit origjinal të monumentit nëpërmjet ndërhyrjeve për ndalimin e degradimeve të mëtejshme dhe nxjerrjen në pah të vlerave të tyre.

"Mbrojtja" është mënyra dhe forma e natyrës juridike ose jo të ruajtjes, mirëmbajtjes, rindërtimit, restaurimit ose konservimit të pasurisë së trashëgimisë kulturore.

Neni 4

Detyrime të institucioneve shtetërore të specializuara në fushën e trashëgimisë kulturore.

Çdo institucion shtetëror i specializuar në fushën e konservimit, mbrojtjes, restaurimit të trashëgimisë kulturore, harton dhe zbaton një program vjetor të specifikuar, për konservimin, mbrojtjen dhe restaurimin e vlerave të trashëgimisë kulturore, program i cili aprovohet nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve (më tej KKR). Në kuadër të këtij programi, çdo lloj ndërhyrje mbi veprat e përmendura në nenin 1, duhet të jetë i ilustruar dhe i justifikuar nga një relacion teknik, nga i cili do të dalin probleme të konservimit të veprës, gjendja aktuale e saj, natyra e ndërhyrjeve të kryera të konsideruara të vlefshme, dhe shpenzimet financiare. Ky relacion do të aprovohet në parim nga institucionet shtetërore të specializuara në këto fusha dhe do të miratohet nga KKR.

Neni 5

Ndërhyrje të ndaluara

Gjatë operacioneve të punës për konservim, mbrojtje dhe restaurim në objekte të trashëgimisë kulturore, të referuara në nenet 1,2 dhe 3, janë të ndaluara pa përjashtim për të gjitha veprat, ndërhyrjet e mëposhtme:

1. Plotësimet, në stil ose ndërhyrje të ngjashme me këtë, edhe kur ato (plotësimet), në dukje mund të udhëzojnë apo ndihmojnë të kuptojmë, se si ka qenë ose duhet shfaqur, pamja e

veprës/monumentit pas përfundimit të ndërhyrjes.

2. Ndërhyrjet ose plotësimet, që fshijnë gjurmët e kalimit të veprës nga një periudhë në tjetrën, ose plotësime në stil që falsifikojnë veprën.

3. Ndërhyrje rindërtimi ose zëvendësimi në vende të ndryshme nga ato origjinalet. Kjo mund të ndodhë, vetëm në se është e detyrueshme nga arsye madhore për shkak të procesit të konservimit.

4. Ndërhyrje në ambientin shoqërues apo plotësues në të cilin është vendosur dhe ka ardhur vepra deri në ditët e sotme, si p.sh. të kompleksit monumental ose ambiental, kompleksit të mobilimit, kopshtit, parkut, etj.

5. Ndryshime ose tjetërsime cipash (patinash).

Neni 6

Ndërhyrje të lejuara

Gjatë operacioneve të punës për konservim, mbrojtje dhe restaurimit në objekte të trashëgimisë kulturore, të referuara në nenet 1,2 dhe 3, lejohen pa përjashtim për të gjitha veprat, ndërhyrjet e mëposhtme:

1. Plotësimi i pjesëve të munguara, në funksion të qëndrimit statik dhe të riintegritetit të pjesëve të vogla, të vërtetuara historikisht, në atë pozicion, duke evidentuar në mënyrë të qartë kufirin mes pjesës së plotësuar por edhe duke adoptuar material të ndryshëm nga origjinali, të aprovuar, të dallueshëm me sy të lirë, në veçanti në pikat e takimit me pjesët origjinale. Plotësimet duhet të jenë të sigluara dhe datuara aty ku është e mundur.

2. Pastrime, që për pikturat dhe skulpturat polikrome nuk duhet të arrijnë kurrë deri tek ngjyra, pra në çdo rast, duke respektuar patinën dhe bojën origjinale. Për të gjitha llojet e tjera të veprave këto pastrime nuk duhet të arrijnë deri në sipërfaqen “e zhveshur” të vetë veprës.

3. Rikompozime të veprave të copëzuara, sistemim të veprave me pjesë të mangëta, duke bërë rigrupime të fragmenteve dhe të masave a pjesëve të dobëta, me një teknikë të dukshme për syrin e lirë, me zona neutrale të vendosura në nivel të ndryshëm nga ai i pjesëve origjinale, ose duke vënë në pah suportin origjinal, por duke mos integruar asnjëherë një “ex novo” në zona me figurina dhe ndërfutur elemente që përcaktojnë figuracionin e veprës.

4. Modifikime dhe ndërhyrje të reja me qëllim qëndrueshmërinë statike dhe konservuese në strukturën e brendshme, vetëm kur këto nuk ndikojnë në pamjen përfundimtare dhe kur pas përfundimit të ndërhyrjes nuk rezultojnë ndryshime kromatike apo sipërfaqësore.

5. Vendosja në një ambient dhe sistemim i ri i veprës, kur nuk ekziston më, ose kur është shkatërruar konteksti ambiental dhe sistemimi tradicional i saj, apo kur kushtet e konservimit kanë ndryshuar.

Neni 7

Masat paraprake për ndërhyrje

Çdo ndërhyrje në vepër duhet kryer në një mënyrë dhe me teknika të tilla që krijojnë bindjen se në të ardhmen ndërhyrje të tjera mbrojtëse apo restauruese në objekt janë të mundshme.

Gjithashtu, çdo ndërhyrje duhet që paraprakisht të jetë e motivuar dhe e preventivuar me shkrim. Duke mbajtur në vazhdim një ditar sipas një formati të përcaktuar më parë, të cilit do ti bashkëngjitet një relacion përfundimtar shoqëruar me dokumentacion fotografik, përpara, gjatë dhe pas ndërhyrjes.

Dokumentohen gjithashtu të gjitha kërkimet dhe analizat fizike, kimike, mikrobiologjike etj. Një kopje e këtij dokumentacion mbahet nga subjekti shtetëror ose privat, vendas apo i huaj që ka kryer ndërhyrjen dhe një kopje tjetër do të dërgohet institucionit të specializuar pjesë e fondit të së cilit është objekti/objektet. Në rastin e pastrimeve, në një zone të objektit, mundësisht në kufi me zonën ku operohet, duhet ruajtur gjendja përpara ndërhyrjes.

Përpara ndërhyrjes konservuese apo restauruese në një vepër apo objekt, duhet të kryhet studimi arkometrik, nëpërmjet së cilit do të njihet përbërja kimike dhe strukturore, rrugët e dëmtimit të veprës, bashkëveprimi me mjedisin dhe materialet e përdorura, në mënyrë që të mundësohet një ndërhyrje e saktë, të sigurohet trashëgimia dhe të nxirren të dhënë për studime në të ardhmen në fusha përkatëse, si teknologji, histori, shkëmbime dhe influenca kulturore etj.

Lëvizja e objekteve nga vendi ku ato ruhen apo ekspozohen në një vend tjetër, bëhet bazuar në Nenin 19 të ligjit 9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar. Në çdo rast lëvizja e veprave kryhet pas hartimit të një projekti të hollësishëm, shoqëruar nga kartelat e gjendjes fizike të veprës dhe procedurave përkatëse.

Neni 8

Përdorimi i metodave dhe lëndëve të reja për restaurim

Përdorimi i metodave dhe lëndëve të reja të restaurimit, bëhet me autorizimin e Këshillit Kombëtar të Restaurimeve, i cili merr vendim, motivuar dhe konform gjykimit të institucioneve të specializuara shtetërore, institucione të cilat detyrohen të promovojnë metodat dhe lëndët e reja, duke mos këshilluar në asnjë rast, lëndë dhe metoda të vjetruara, të dëmshme, jo të kolauduara.

Neni 9

Masa mbrojtëse nga agjentët atmosferikë, termikë dhe higrometrikë

Masat e mara në funksion të ruajtjes së vlerave të objekteve të përmendura në nenin 2 të kësaj Karte, nga veprimet e dëmshme dhe variacionet e agjentëve atmosferikë, termike dhe higrometrike, nuk duhet të jenë të tilla që të tjetërsojnë pamjen dhe ngjyrën e sipërfaqes së objektit, apo të ndikojnë në modifikimin dhe ndryshimin thelbësor dhe të përhershëm të kontekstit ambiantal në të cilin veprat janë përcjellë historikisht.

Në rast se të tilla modifikime, janë të domosdoshme, me qëllim konservimin, mbrojtjen dhe restaurimin e objekteve, ato duhen kryer duke evituar çdo lloj cenimi në pamjen e objektit dhe në ambientin në të cilin ai është përshtatur.

Neni 10

Roli i KKR për zbatimin e rregullave të kartës shqiptare të restaurimeve

Në rast se krijohen mosmarrëveshje me atributet, kompetencat dhe mënyrën e ndërhyrjes teknike në restaurimin e objektit, ose lindin probleme të ngjashme të këtij lloji, mes subjektit që ka realizuar ndërhyrjen dhe mbikëqyrësit të ndërhyrjes, ato zgjidhen duke paraqitur mosmarrëveshjen në Këshillin Kombëtar të Restaurimeve.

Ky organ, brenda një periudhe prej 15 ditësh, merr vendimin përkatës për rastin e paraqitur. Vendimi i Këshillit Kombëtar të Restaurimeve, për këtë rast, është i detyrueshëm për tu zbatuar

dhe nuk mund të ankimohej.

Neni 11

Metoda specifike të ndërhyrjes

Metodat më specifike të cilat përdoren si procedura restaurimi posaçërisht për monumentet arkitektonike, pikturat, skulpturat, qendrat historike në kompleksin e tyre, përjashtuar gërmimet arkeologjike, janë të specifikuar në shtojcat a, b, c, d, e, f të rregullave të mëposhtme.

SHTOJCA A

RREGULLA PËR KONSERVIMIN, MBROJTJEN DHE RESTAURIMIN E

OBJEKTEVE ARKEOLOGJIKE

Përveç normave të përgjithshme të përfshira në nenet e Kartës së Restaurimit, në fushën e arkeologjisë duhet të kihet parasysh, rregulla të veçanta, për mbrojtjen, ruajtjen dhe restaurimin e gjetjeve gjatë kërkimeve tokësore ose nënujore në referencë me nenin 2.

Problem i rëndësishëm i veçantë, mbrojtja e nëntokës arkeologjike, është domosdoshmërisht i lidhur me një sërë dispozitash ligjore që kanë të bëjnë me shpronësimet, aplikimin e detyrimeve të veçanta, krijimin e parqeve arkeologjike. Në bashkëshoqërim të masave që duhen ndërmarrë në raste në ndryshme, do të jetë gjithnjë njohja e kujdesshme e terrenit, për të mbledhur të dhëna të dukshme në sipërfaqe, materiale qeramike të shpërndara, dokumentim të elementëve që vërtetojnë mbetje arkeologjike. Të gjitha këto, duke përdorur edhe mënyra të tilla si, fotografimi nga ajri, hulumtimet përmes metodave gjeofizike, etj. Këto ndihmojnë, në njohjen sa më të plotë të natyrës arkeologjike të terrenit, në aplikimin e normave të mbrojtjes së natyrës, në detyrimin për përpilimin e planeve rregulluese, si dhe për mbikëqyrjen në rastet e ekzekutimit të ndërtimeve të reja.

Për mbrojtjen e pasurisë arkeologjike nënujore, nga kërkimet nënujore që cenojnë reliket e anijeve antike dhe ngarkesat e tyre, rrënojat dhe skulpturat e fundosura etj, është e detyrueshme marrja e masave të veçanta, duke filluar nga eksplorimi sistematik i bregdetit shqiptar me personel të specializuar dhe deri tek hartimi i një “Regjistri detar” me indikacione dhe dokumentime për të gjitha reliket dhe monumentet e zbuluara, me qëllim si mbrojtjen e tyre ashtu edhe programimin e kërkimeve shkencore nënujore. Rikuperimi i një relike të një anije antike nuk duhet të fillojë para se të parapërgatitet vendi dhe të jenë siguruar aparaturat e nevojshme që lejojnë zbulimin e materialeve që do të rikuperohen nga fundi i detit si dhe pasi të jenë parashikuar të gjitha trajtimet e mëvonshme speciale, që kërkojnë para së gjithash pjesët e drunjtë, nëpërmjet larjeve të vazhdueshme, me substancë speciale konsolidante në ambiente dhe temperaturë të kondicionuara dhe trajtime të tjera të nevojshme konservuese.

Mënyrat e nxjerrjes dhe rikuperimit nga uji të anijeve të mbytura, duhen studiuar rast pas rasti, në varësi të gjendjes dhe veçantisë së relikes, duke pasur parasysh eksperiencat ndërkombëtare, sidomos dekadat e fundit. Në këto lloje specifike kërkimesh dhe gjetjesh, ashtu si dhe në eksplorimet arkeologjike tokësore, duhet të përshtaten metoda speciale për konservimin dhe restaurimin e objekteve, sipas llojit dhe lëndës së tyre. Për shembull, për materialet e qeramikës dhe amforat merren të gjitha masat që lejojnë identifikimin e mbetjeve ose gjurmëve të mundshme, të dhëna të vlefshme për historikun e tregtisë së kryer dhe mënyrën e jetës në antikitet. Vëmendje e veçantë i duhet kushtuar fiksimit të përshkrimeve të pikturave, sidomos atyre mbi trupin e amforave.

Gjatë eksplorimeve arkeologjike tokësore ku normat e rikuperimit dhe dokumentimit hyjnë në

mënyrë më specifike në kuadrin e normave të lidhura me metodologjinë e gërmimit, për sa i përket restaurimit, duhen hetuar të gjitha dokumentimet dhe faktet, që gjatë operacionit të gërmimit, garantojnë konservimin e menjëhershëm të objekteve të zbuluara, sidomos të atyre më delikate duke mundësuar kështu mbrojtjen dhe restaurimin përfundimtar të objektit/objekteve.

Në rastin e gjetjes së elementeve të shpërbëra të dekoracioneve në stuko, në pikturë, në mozaik ose në “opus sectile” është e nevojshme që para dhe gjatë lëvizjes së tyre, këta elementë të mbahen të bashkuar, me garza dhe me ngjitës të përshtatshëm, në mënyrë që më vonë të lehtësohet rikompozimi dhe restaurimi në laborator.

Në rastin e gjetjes së objekteve prej qelqi, është e këshillueshme të mos kryhet asnjë pastrim gjatë operacionit të zbulimit, pasi janë objekte mjaft delikate.

Për sa i përket qeramikës dhe terrakotës është e rëndësishme të mos kryhen lavazhe dhe pastrime të nxituara, kur ka prezencë të pikturave, shkrime, bojëra. Kujdes i veçantë duhet bërë edhe në mbledhjen e objekteve ose fragmenteve të metalit, veçanërisht atyre të oksiduara, duke punuar si me mënyrat moderne të konsolidimit ashtu edhe me suporte speciale.

Me qëllim vënien në jetë të këtyre rregullave është e nevojshme që gjatë kryerjes së gërmimeve, të garantohet pjesëmarrja e restauratorëve që në ndërhyrjen e parë të rikuperimit dhe fiksimit. Vëmendje e veçantë i duhet kushtuar problemit të restaurimit të veprave të artit të destinuara për të mbetur, ose për tu rivendosur (në se hiqen), në vendin origjinal, veçanërisht kjo për pikturat dhe mozaikët. Duhet të mbahet parasysh operimi me lloje të ndryshme të suportesh (mbajtësesh), kornizash dhe ngjitësish, në përputhje dhe varësi me kushtet klimatike, atmosferike dhe higrometrike, që për pikturat lejon përshtatjen në ambiente të favorshme të mbuluara, të një ndërtese antike, duke evituar kontaktin direkt me sipërfaqen e murit dhe duke realizuar kështu një montim dhe konservim të sigurt. Duhet evituar gjithashtu përdorimi i bojërave ose i dyllit për të theksuar ngjyrat pasi kjo mënyrë mund të bëhet shkak për ndryshim të pamjeve të origjinalit. Në të tilla raste mjafton vetëm një pastrim i sipërfaqeve origjinale.

Sa i përket mozaikëve, kur është e mundur preferohet, rivendosja e tyre në ambientin apo ndërtesën, ku kanë qenë historikisht të vendosura, poqes, pas të cilit formohet dekoracioni dhe pamja e plotë e tij në kontekst me ambientin. Shkëputja e tij, pa operuar me çarje, me metodat moderne mund të kryhet edhe për sipërfaqe të mëdha. Gjithashtu sistemi i çimentimit në suport metalik të paoksidueshme tani për tani rezulton më efikas dhe rezistenti ndaj agjentëve atmosferikë.

Për mozaikët e destinuar për ekspozim në muze, përdoret gjerësisht suporti i tipit “sandwich” me materiale të lehta, rezistente dhe lehtësisht të menaxhueshme.

Vëmendje e veçantë, për mbrojtjen nga rreziqet që vijnë nga ndryshimet klimatike, meritojnë pikturat murale të interierëve, (në shpellat prehistorike, varret, ambiente të vogla); Në këto raste është e nevojshme të mbahen konstantë dy faktorë thelbësorë për një konservim sa më të mirë të pikturave, shkalla e lagështisë dhe temperatura e tij. Këto faktorë ndryshojnë lehtë nga shkaqe dhe faktorë të jashtëm ambiental, sidomos nga hyrje-daljet e vizitorëve, nga ndriçimi i tepërt, nga ndryshime të forta atmosferike. Prandaj, është e nevojshme, të menaxhohet me kujdes prania e vizitorëve, të krijohen tamponë të klimatizuar mes ambientit antik që mbrohet dhe ambientit të jashtëm.

Për restaurimin e monumenteve arkeologjike, përveç normave të përgjithshme që përmban Karta Shqiptare e Restaurimit dhe rregullave të restaurimeve arkitektonike, duhen marrë në konsideratë edhe disa nevoja në lidhje me teknikat e specifike antike. Mbi të gjitha, kur bëhet fjalë për restaurimin e plotë të një monumenti dhe studimin e tij historik, duhen marrë kampione gërmimi nëpërmjet zbulimit të themeleve. Operacionet duhet të udhëhiqen nga zbatimi i metodave

bashkëkohore të njësive stratigrafike, metoda të cilat mund të ofrojnë të dhëna të vlefshme për ngjarjet dhe fazat në të cilat ka kaluar monumenti.

Për restaurimin e strukturave të punuara me teknikë kuadratike, është eksperimentuar me sukses rikrijimi i blloqeve në përmasat antike, duke përdorur grimca (pjesë) nga materiali origjinal, të çimentuara dhe në sipërfaqe me llaç të përzier me pluhur të materialit origjinal, për të arritur intonacionin kromatik. Në disa raste mund të këshillohet një trajtim i ndryshëm sipërfaqësor me materiale të reja si dhe me gdhendje të përshtatshme. Në fund është e nevojshme të vendosen në çdo zonë të restauruar pllakëza me datën, siglën ose shenja dalluese të veçanta.

Përdorimi i çimentos në sipërfaqe të riveshura me pluhur nga materiali i monumentit që restaurohet, mund të rezultojë i nevojshëm edhe në ngjitjen e blloqeve dhe kolonave antike prej mermeri, shtufi ose gëlqereje, duke marrë në konsideratë tonin konciz në raport me monumentin. Në ambiente romake mermeri i bardhë mund të integrohet me travertinë ose gëlqeror duke iu referuar eksperimenteve të kryera deri tani. Në monumentet antike dhe veçanërisht ato të epokës arkaike ose klasike duhet evituar afrimi i materialeve të ndryshme dhe anakronike në pjesët e restauruara, sepse rezultojnë “ofensiv” nga këndvështrimi kromatik, ndërkohë që mund të përdoren zgjidhje me materiale me të cilat është konstruktuar vetë monumenti.

Një problem i specifik për monumentet antike janë mbulesat e mureve të dëmtuara dhe mbi të gjitha mbajtja e linjës së dhëmbëzuar të rrënojës. Për këtë arsye, rekomandohet përdorimi i një shtrese argjile e përzier kjo me pluhur qeramike, metodë kjo që ka dhënë rezultate të mira në këndvështrimin estetik dhe të rezistencës ndaj agentëve atmosferikë. Përsa i përket problemit të përgjithshëm të konsolidimit të materialeve arkitektonike dhe të skulpturave në ambient të hapur, duhen evituar eksperimentimet me metoda që nuk kanë dhënë rezultate të mira, pasi mund të sjellin dëme të pakthyeshme. Në çdo rast, marrja e masave për restaurimin dhe konservimin e monumenteve arkeologjike duhet studiuar në raport me nevojat e ndryshme klimatike në ambiente të ndryshme.

SHTOJCA B

RREGULLA PËR KRYERJEN E RESTAURIMEVE ARKITEKTONIKE

Që ndërhyrjet restauruese të mundësojnë jetëgjatësinë e monumenteve të kulturës, rekomandohet mbikëqyrja e vazhdueshme e objekteve monument kulture dhe marrja e masave parandaluese, në fund të fundit edhe për evitimin e ndërhyrjeve në shtrat të gjerë. Duhet marrë parasysh faktin që të gjitha operacionet e ndërhyrjeve restauruese, ti përmbahen thelbit tradicional (konservativ), duke respektuar elementët e shtuar në kohëra dhe duke evituar ndërhyrjet e reja. Duke pasur si qëllim mbijetesën e monumenteve, duhet konsideruar mundësia e rijetëzimit të ndërtesave antike monumentale, me kusht që funksioni i ri të mos dëmtojë vlerat e monumentit dhe të jetë i përputhur me interesat historike dhe artistike të tij. Ndërhyrjet adoptuese duhet të kufizohen në minimum duke ruajtur rreptësisht format e jashtme dhe duke evituar tjetërsime të ndjeshme të tipologjisë individuale, të organizmit konstruktiv dhe brendisë së veprës. Hartimi i projektit për restaurimin e një vepre arkitektonike duhet të paraprihet nga një studim i kujdesshëm mbi monumentin në shumë këndvështrime (që provojnë pozicionin e saj në kontekstin territorial ose urban, aspektet tipologjike, strukturën e saj etj.), studim i cili lidhet me veprën origjinale dhe me shtesat e mëtejshme ose modifikimet në kohë.

Pjesë përbërëse e këtij studimi do të jenë edhe kërkimet bibliografike, ikonografike dhe arkivistike për të kuptuar çdo të dhënë historike. Projekti duhet të bazohet në një rilevim të kompletuar grafik dhe fotografik të kujdesshëm, për të verifikuar drejt, stabilitetin e monumentit.

Ekzekutimi i ndërhyrjeve dhe të gjitha punimet e restaurimit të monumenteve, meqenëse janë operacione delikate dhe me shumë përgjegjësi, duhet ti besohen institucioneve shtetërore të specializuara dhe të ngarkuara me ligj, si edhe subjekteve private të specializuara dhe të licencuara për këtë qëllim. Operacionet e restaurimit duhen vëzhguar vazhdimisht për të siguruar një ekzekutim sa më të mirë dhe për të ndërhyrë në mënyrë shkencore atëherë kur manifestohen fakte të reja, vështirësi ose çrregullime. Duhet evituar përdorimi i “kazmës dhe çekiçit”, që mund të zhdukë elemente të panjohur apo të injoruar më parë, por që janë të nevojshëm për njohjen, studimin e veprës dhe kryerjen e një restaurimi sa më perfekt të saj. Në veçanti, drejtuesi i punimeve, përpara se të trajtojë muraturën, ose të lëvizë suvatë duhet të sigurohet për ekzistencën ose jo të çfarëdolloj gjurme dekoracioni apo afresku në origjinë të veprës.

Domosdoshmëri esenciale e restaurimit është respektimi i mbrojtjes së autenticitetit të elementëve përbërës të veprës. Ky princip duhet të udhëheqë dhe të kushtëzojë gjithnjë zgjedhjet operative. P.sh. në rastin e mureve “jashtë qendre” edhe pse nevojat mund të sugjerojnë njëherë prishjen e më pas rikonstruksionin e tyre, duhet ekzaminuar paraprakisht mundësia e restaurimit, pa zëvendësuar muraturën origjinale. Kështu që, zëvendësimi i gurëve të gërryer e shumë të dëmtuar, mund të kryhet vetëm për nevoja, shumë të domosdoshme.

Zëvendësimet dhe bashkimet eventuale të veshjeve të jashtme të mureve, duhet të bëhen në limite të përcaktuara qartë dhe të jenë të dallueshme nga elementët e tjerë origjinalë. Zakonisht preferohet të operohet përgjatë periferisë së bashkimit me një shenjë të qartë dhe të dallueshme të ndërhyrjes. Konsolidimi i gurëve ose i materialeve të tjera duhet përdorur kur këto metodat janë eksperimentuar më parë nga Instituti i Monumenteve të Kulturës dhe kanë dhënë garanci efektive. Çdo veprim duhet kryer para se gjendja fizike e monumentit të rëndohet. Pra duhet ndërhyrë për të eliminuar shkaqet dhe rrjedhimisht dëmtimet. P.sh. sapo vërehen gurë të thyer apo të liruar nga lidhjet metalike, nëpërmjet të cilëve mund të penetrojnë lagështia dhe muri të fillojë të bymehet, duhet çmontuar pjesa e dëmtuar dhe të zëvendësohen lidhjet e hekurit me lidhje bronzi ose bakri, ose më mirë me çelik të paoksidueshëm, që ka si avantazh të mos njollosë gurët.

Skulpturat prej guri të vendosura në ambiente të jashtme të ndërtesave ose në sheshe, duhen vrojtuar vazhdimisht për të ndërhyrë në kohën e duhur, duke marrë masa mbrojtëse qoftë edhe sezonale. Kur të gjitha këto masa nuk japin rezultat, skulpturat duhen transferuar në ambiente të mbyllura. Ndërsa për konservimin sa më të mirë të shatërvanëve prej guri ose bronzi, duhet bërë dekalçifikimi i ujërave duke eliminuar kështu kripëzimin e pjesëve dhe pastrimet e shpeshta që mund ta dëmtojnë veprën.

Cipa (patina) e gurëve duhet ruajtur për arsye historike, estetike, teknike dhe për funksionet e tij mbrojtëse ndaj gërryerjes e cila siç dihet fillon nga sipërfaqja e objektit. Lëndët e akumuluar mbi gurë – depozitime, pluhura, blozë, etj, pastrohen duke përdorur furça organike ose presion ajri apo avulli të moderuara. Duhet evituar furçat metalike, krueset, dhe nuk këshillohen gjithashtu presione ajri të forta me rërë natyrale, ujë apo avull.

SHTOJCA C

RREGULLA PËR RESTAURIMIN E PIKTURAVE DHE SKULPTURAVE

Operacione paraprake

Operacioni i parë për tu kryer para çdo ndërhyrjeje restaurimi mbi çdo vepër arti, pikturë ose skulpturë, është njohja e kujdesshme e gjendjes së konservimit të strukturës. Në të tillë njohje

bën pjesë përcaktimi i shtresave të ndryshme të lëndëve me të cilat përbëhet vepra, nëse janë origjinale ose të shtuara, si edhe epokat në të cilat janë bërë ndërhyrjet dhe modifikimet. Pra duhet të mbahet parasysh se duhet hartuar dhe përmbledhur një ditar (kartelë) e restaurimit të veprës. Në vazhdimësi këtë proces e ndjek fotografimi dhe dokumentimi i gjendjes para ndërhyrjes dhe fotografi të tjera, sipas rasteve, të kryera në dritën natyrale, në dritën monokromatike, rrezet ultraviolet të thjeshta ose të filtruara ose ato infra të kuqe.

Në rastet ku nuk dallohen mbivendosjet e shtresave me sy të lirë, duhet kryer radiografia me rrezet përkatëse që nuk dëmtojnë pikturën.

Në rastin e pikturave të lëvizshme (jo murale) duhet fotografuar edhe pjesa e prapme (e mbajtëses) së pikturës. Nëse nga dokumentimi fotografik, do të rezultojnë elemente problematikë, ato duhet të referohen dhe të përfshihen në ditar dhe me të gjithë problematikën e tyre. Pas fotografimit duhet operuar me të gjitha shtresat, edhe ato më të imtat, deri në support, për të parë dhe realizuar sesione stratigrafike, nëse ekzistojnë shtresëzime ose jo. Këto sesione merren nga pjesë periferike të pikturës. Pikat e këtyre sondazheve duhen shënuar edhe në fotografitë e kryera në dritën natyrale dhe referohen në ditar (kartele).

Për sa i përket pikturave murale, ose mbi gur, terrakotë ose mbështetëse tjetër (të palëvizshme), duhet të sigurohemi për kushtet fizike të suportit, në raport me lagështirën. Duhet të përcaktohet nëse ka lagështirë të infiltuar, të kondensuar apo kapilare duke marrë kampione të llaçit dhe të përbërjes së murit, të cilat analizohen duke matur kështu shkallën e lagështirës. Gjithashtu bëhen analiza mikrobiologjike, në se dyshohet ose duken formacione biologjike.

Problemi më i veçantë i skulpturave, është përcaktimi i gjendjes të konservimit të lëndës me të cilën janë krijuar. Kjo arrihet nëpërmjet kryerjes së radiografive, gamagrafivë, ultratingujve, valëve magnetike etj.

Sondazhet paraprake ndihmojnë, orientojnë dhe mundësojnë ndërhyrjen e restaurimit në mënyrën e duhur, si në rastin kur bëhet fjalë për pastrime të thjeshta, për fiksime, për lëvizje të shtresave të ripikturimeve, zhvendosje të tyre ashtu dhe për rikompozim të fragmenteve. Megjithatë, hetimi (studimi) më i rëndësishëm për pikturën, është përcaktimi i teknikës së përdorur, gjë e cila jo gjithmonë mund të ketë një përgjigje shkencore dhe për këtë arsye duhet kujdes në aplikimin e materialeve që do të përdoren për restaurimin e saj.

Integrimi në pikturë, duhet të jetë interpretim kritik i mungesës së imazhit dhe nuk duhet kryer atje ku ai (imazhi) mungon. Në çdo rast materialet e përdorura, duhet të jenë reversibël dhe të dallueshme nga ato origjinale.

Për sa i përket pastrimeve, kjo mund të bëhet kryesisht në dy mënyra: me mjete mekanike ose me mënyra kimike. Duhet përjashtuar çdo lloj mjeti që zhduk vizibilitetin (pamjen) ose mundësinë e ndërhyrjes dhe kontrollin direkt mbi pikturë. Mjetet mekanike (bisturitë) duhen përdorur gjithnjë nën kontrollin e pinakoskop-it. Mjetet kimike (solucionet dhe shkrirësit) duhet të jenë të një natyre të tillë që të kenë pikën e duhur të avullimit me qëllim që të mos depërtojnë në shtresat e pikturës dhe që më pas të neutralizohen menjëherë me solucione përkatëse duke evituar kështu fiksimin në shtresat e pikturës. Përpara se këto lëndë të përdoren duhen eksperimentuar, për tu siguruar që nuk dëmtojnë cipën (patinën) origjinale të pikturës. Përpara se të vazhdohet me pastrimin, me çfarëdo lloj mjeti të lejuar që ai do të kryhet, duhet kontrolluar me hollësi pozicioni statik i pikturës, në çfarëdo suporti që të jetë vendosur, duke vazhduar më tej me fiksimin e pjesëve të shqitura ose të rrezikuara. Sido që të kryhet ky fiksime, lokalisht ose nëpërmjet një solucion të shpërndarë në mënyrë uniforme, penetrimi i tij (solucionit), arrihet përmes një vatre nxehtësie konstante dhe jo të rrezikshme për konservimin e pikturës. Por me çfarëdo mënyre që të jetë kryer fiksimi është rregull që të hiqet çdo gjurmë që mbetet nga lënda

fiksuese mbi sipërfaqen e pikturuar. Për këtë qëllim, pas fiksimit duhet kontrolluar ndërhyrja në pinakoskop.

Për sa i përket trajtimit me shtresë solucion të të gjithë pikturës, është e detyrueshme që kjo të përdoret pas konsolidimit të pjesëve të ngritura dhe/ose të rrezikuara. Lënda e përdorur duhet të jetë një ngjitës i holluar dhe i ndryshëm nga ai i përdorur gjatë procesit të fiksimit.

Nëse suporti i pikturës është i drunjtë, i ngjitur, me krimba, termite, etj, ajo (piktura) duhet të nënshtrohet operacioneve të dezinfektimit me gazra specifike, për të vrarë insektet, pa dëmtuar pikturën. Duhet evituar trajtimet me substanca të lëngëta.

Në rastet kur suporti i drurit, është plotësisht i dëmtuar duhet të merret në konsideratë zhvendosja e pikturës mbi një suport tjetër.

Nëse gjendja e grundit, ose të dyja së bashku, për pikturat e luajtshme (jo murale), është e dëmtuar, duhet që grundit i pikturës të shkëputet i gjithi me bisturi. Aty ku është e mundur, grundit duhet konservuar ashtu siç është, për të ruajtur origjinalitetin e pikturës. Në rastet kur grundit mungon, ai duhet zëvendësuar për arsye strukturale dhe estetike.

Kur zëvendësimi i suportit të drurit përbën domozdoshmëri, për shkak të dëmtimeve të pariparueshme, këshillohet një suport tjetër prej materiali drusor rezistent me parametra shumë të mirë stazhionimi, stabiliteti e që ti rezistojë ndryshimeve në kohë.

Në rast se suporti origjinal prej druri, është në gjendje të mirë, por ka nevojë për drejtim, përf forcime ose parketim, gjë e cila ndikon vetëm estetikisht, është më mirë të mos ndërhyhet në një dru të vjetër dhe tashmë të stabilizuar. Edhe në se ndërhyhet, kjo duhet bërë duke respektuar rregulla precize teknologjike. Nga druri duhet të merret një seksion, të hetohet botanika e tij dhe të analizohet treguesi i lagështirës. Çdo lloj shtese, duhet të bëhet me dru të stazhionuar dhe me segmente të vogla me qëllim që të përshtatet sa më mirë me suportin e vjetër tek i cili montohet. Parketimi, me çfarëdo materiali që kryhet, duhet të sigurojë lëvizjet natyrore të drurit mbi të cilin fiksohet.

Për pikturat me kornizë origjinale, korniza rekomandohet të mos hiqet, përveç rasteve kur ajo nuk mund ta kryejë më funksionin e saj për shkak të dëmtimeve të rënda që mund të ketë pësuar. Në rastin kur korniza mungon apo duhet zëvendësuar, në çdo rast duhet respektuar periudha në të cilën është realizuar vepra dhe e gjithë krijimtaria e autorit që ka realizuar veprën.

Operacioni i restaurimit në pëlhurën e pikturës, sido që të realizohet, duhet të evitohet ngjeshjet e tepërta dhe temperaturat shumë të larta për pelikulën e pikturuar. Gjatë heqjes së pikturës nga mbajtësja e vjetër prej druri apo kanavace duhet të ruhen nënshtresat dhe format origjinale të sipërfaqes së pikturuar. Nëse bordurat e pëlhurës, janë të konsumuara, ato mund të përforcohen me shirita prej pëlhure, në mënyrë të tillë që të mos kapërcejnë bordin e telajos mëm pelikulën e pikturës. Duhet të evitohen gjithnjë, në mënyrën më taksative operacionet e aplikimit (“transportimit”) të një pikturë nga telajo mbi një suport të ashpër. Telajot duhet të jenë të konceptuara në mënyrë të tillë që të sigurojnë jo vetëm tensionin e duhur, por edhe të stabilizojnë automatikisht pikturën në raste të ndryshme termoigrometrike.

Pikturat murale janë pjesë përbërëse e arkitekturës. Heqja apo zhvendosja e tyre është gjithmonë “tronditëse” për pikturën dhe për këtë arsye ajo duhet të jetë e justifikuar dhe duhet kryer vetëm në se ndërtesa apo suporti ku piktura është vendosur rrezikohet të shkatërrohet.

Nëse bëhet fjalë për tempera, dhe përgjithësisht për pjesët në tempera të afreskeve ku disa ngjyra nuk mund të rifreskohen, duhen kryer fiksime parandaluese. Ndonjëherë kur ngjyrat e pikturës murale i nënshtrohen një gjendjeje pak a shumë të avancuar të pluhurizimit, duhet një kujdes i veçantë për pastrimin, në mënyrë që të parandalohet zhvendosja e pluhurit të ngjyrës origjinale. Për fiksimin e ngjyrës, duhet të përdorim fiksues me natyrë joorganike, duke forcuar sa më pak

të jetë e mundur tonet origjinale. Pluhuri duhet ekzaminuar për të parë nëse përmban formacione të dëmshme dhe cilat janë arsyet në se kjo vërtetohet. Në se gjendet shkaku i formimit të këtyre formacioneve dhe solucioni i duhur për luftimin e tyre, duhet të sigurohemi se këto solucione nuk dëmtojnë pikturën dhe mund të pastrohen kollaj.

Për sa i përket mbështetëses (suportit) mbi të cilën do të rivendoset piktura, duhet që ai të ofrojë garanci stabiliteti, inerci dhe neutralitet. Duhet gjithashtu që suporti të ndërtohet në dimensionet e pikturës, pa qepje të ndërmjetme që mund të dilnin papritur me kalimin e kohës mbi sipërfaqen e pikturës. Ngjitësi me të cilin do të fiksohet piktura mbi mbështetësen e re, duhet të jetë i tillë që të shkrihet me lehtësi me një lëndë që nuk e dëmton pikturën.

Mozaikët, është e rekomandueshme, që të ruhen në vendin e tyre në monument. Në rastet kur paraqitet e domosdoshme heqja e tyre duhet të sigurohemi që kubat e mozaikut edhe pse nuk përbëjnë një sipërfaqe komplet të sheshtë mund të jenë të riaplikueshme në një tjetër vendosje (sipërfaqe). Përpara se të aplikohet rrjeta e armaturës së re mbështetëse, duhet të sigurohemi për gjendjen fizike të kubikëve të mozaikut dhe të kryejmë ndonjë konsolidim të mundshëm. Një kujdes i veçantë duhet të tregohet në konservimin e karakteristikave tektonike të sipërfaqes së mozaikut.

Masa që duhen marrë në konsideratë gjatë procesit të restaurimit të skulpturave

Pas përcaktimit të lëndës dhe më tej teknikës që është ndjekur në krijimin e skulpturave (mermer, gur, stuko, brumë letre, terrakotë, baltë e pjekur, baltë jo e pjekur por e pikturuar, allçi si kopje e parë etj), edhe kur nuk rezultojnë pjesë të pikturuara dhe është i nevojshëm pastrimi, përjashtohet kryerja e lavazheve të tilla që, edhe pse nuk cenojnë lëndën, mund të dëmtojnë cipën (patinën). Prandaj, në rastet e skulpturave të nxjerra gjatë gërmimeve, ose të gjetura në ujëra (dete e lumenj, etj), nëse mbi këto është formuar cipë gëlqerore, kjo duhet të pastrohet me mjete mekanike, ose me solucione të tillë që nuk cenojnë materialin e skulpturës dhe që nuk fiksohen.

Për skulpturat në dru, dhe që janë në gjendje rreziku, përdorimi i lëndëve fiksuese duhet të jetë në varësi të ruajtjes së pamjes origjinale të lëndës drusore. Nëse druri është infektuar nga miza, insekte, etj, duhet ti nënshtrohet trajtimit me gazra të përshtatshëm. Nëse ndërhyhet për ti drejtuar, lidhur apo/dhe integruar duhet vepruar nëpërmjet rregullave teknologjike të përcaktuara saktë që respektojnë vijueshmërinë e fibrave të drurit duke përdorur në çdo rast të njëjtin lloj botanik.

Në këto objekte, edhe pse mund të mungojnë pjesët e pikturuara, duhet evituar trajtimi me solucione që, mund të shndërrojnë pamjen e drurit. Në rastin e skulpturave të fragmentuara përdorimi i bashkuesve ose mbështetësve duhet të jetë në vartësi të zgjedhjes së një metalit të paoksidueshëm.

Për skulpturat në allçi, si kopje të para (origjinale), lëvizja nga vendi ku ruhen, lejohet vetëm në rastin kur ka një kopje të dytë.

Për objektet në bronz rekomandohet një kujdes i veçantë për ruajtjen e patinës, nëse tek to nuk vërehen gjëryerje të shkallës së lartë.

Rregulla të përgjithshme për rivendosjen në ambient të veprave të restauruara të artit

Si linjë absolute restaurimi nuk rekomandohet asnjëherë rivendosja e një vepre të restauruar në vendin e saj origjinal, nëse restaurimi është kryer i kushtëzuar nga kushtet termogrometrike të vendit në përgjithësi ose të një pjese në veçanti, në rast se vendi ose pjesa e vendit nuk kanë pësuar ndërhyrje të tilla (përmirësime, klimatizime, etj) që garantojnë konservimin dhe mbrojtjen e veprës së artit në të ardhmen.

SHTOJCA D

RREGULLA PËR MBROJTJEN E “QENDRAVE HISTORIKE”

Me qëllim individualizimin e qendrave historike, duhen marrë në konsideratë jo vetëm qendrat “e vjetra” urbane tradicionale, por në një kuptim më të gjerë trajtohen si të tilla edhe të gjitha vendbanimet humane, ku strukturat e tyre, të përbashkëta apo të fragmentuara, edhe pse të transformuara pjesërisht nga koha, kanë përbërë në të kaluarën, ose në epokat që kanë pasuar më vonë, ngjarje me vlera të veçanta për dëshmitë historike, si edhe vlera të spikatura urbanistike dhe arkitektonike. Karakteri historik i të ashtuquajturave vendbanime i referohet vlerave që ato sjellin për dëshmitë e civilizimit të kaluar dhe dokumentimit të kulturës qytetare, pavarësisht nga vlerat e tyre artistike dhe formale apo aspekti i tyre ambiental, që i pasurojnë ato me vlera më të mëdha, jo vetëm për arkitekturën por edhe strukturën urbanistike që në vetvete mbart domethënie të konsiderueshme.

Ndërhyrjet e restaurimit në qendrat historike kanë si qëllim garantimin nëpërmjet mjeteve dhe instrumenteve të zakonshme dhe të veçanta – të vazhdimësinë në kohë të vlerave që karakterizojnë këto komplekse. Ky restaurim nuk kufizohet vetëm në operacione për konservimin e karakterit formal të arkitekturave ose ambienteve të veçanta, por shpërndahet në konservimin në esencë të karakteristikave të përbashkëta të gjithë ansamblit urbanistik dhe të të gjitha elementeve që përcaktojnë këto karakteristika. Që ansamblet urbanistike në fjalë të mund të mbrohen, zhvillohen dhe të mbijetojnë në kohë e në vazhdimësinë në jetën civile dhe moderne, duhet që mbi të gjitha, qendrat historike të jenë të organizuara në kontekstin e tyre më të gjerë urban dhe territorial, në raport me zhvillimet e ardhshme: Në fund të fundit, kjo duke koordinuar zhvillimet urbanistike në mënyrë të tillë që të sigurohet mbrojtja dhe rikuperimi i qendrës historike duke nisur fillimisht nga pjesa periferike e qytetit, përmes një programimi të përshtatshëm të ndërhyrjeve në territor.

Mund të konfigurohet kështu, përmes instrumenteve të tilla, një ansambël i ri urban, në të cilin qendrave historike iu hiqen ato funksione, të cilat pengojnë dhe nuk përshtaten me rikuperimin dhe mirëmbajtjen e këtyre qendrave, në kuptim të konservimit sa më të mirë të tyre. Ky konfigurim dhe koordinim duhet parë edhe në raport me nevojën për mbrojtjen e kontekstit të përgjithshëm territorial ambiental, mbi të gjitha kur ky i fundit ka vlera domethënëse e të veçanta, të cilat lidhen me strukturat historike të transmetuara deri në ditët e sotme.

Për sa i përket elementëve të veçantë përmes të cilëve zbatohet mbrojtja e ansamblit në të gjithë bashkësinë e tij, merren në konsideratë si elementë të shumtë të ndërtimit, ashtu edhe elementët që mbushin hapësirat e jashtme (rrugë, sheshe, etj), hapësirat e brendshme (kopshte, parqe, hapësira të lira, etj), struktura të tjera domethënëse (mure, porta, etj) dhe përveç tyre dhe elementë të tjerë natyrore që shoqërojnë gjithë këtë bashkësi si (konture natyrore, rrjedhje ujore, veçanësi gjeomorfologjike, etj). Elementët e mësipërm të ndërtimit duhen konservuar jo vetëm në aspektin e tyre formal që karakterizon shprehjen arkitektonike apo ambientale të tyre, por edhe në karakterin e tyre tipologjik, për të shprehur funksionet që me kalimin e kohës tregojnë përdorimin e vetë këtyre elementëve.

Çdo ndërhyrjeje restaurimi në vlerat urbanistike, arkitektonike, ambientale, tipologjike, ndërtuese, i paraprin një operacion i kujdesshëm i leximit historiko-kritik, meqenëse në të gjithë kompleksin, përcaktuar si qendër historike, duhet operuar sipas kriterëve homogjene, për individualizimin e niveleve të ndryshme të ndërhyrjes në nivel urbanistik dhe nivel ndërtimi, duke e kualifikuar ndërhyrjen si “përmirësim konservues” të nevojshëm. Me “përmirësim

konserve” do të kuptohet para së gjithash mirëmbajtja e strukturave ndërtimore në përgjithësi, si dhe ruajtja e karakteristikave të përgjithshme ambientale, gjë e cila sjell ruajtjen integrale të ansambleve monumentale dhe ambientale më domethënës dhe përshtatjen e elementëve të tjerë ose organizmave (veprave) të veçanta të ndërtimit me nevojat e jetës moderne, duke konsideruar të jashtëzakonshme zëvendësimet, qoftë edhe të pjesshme, të vetë elementëve dhe vetëm atëherë kur ato (elementet) përshtaten dhe adoptohen me karakterin e përgjithshëm të qendrës historike. Ndërhyrjet kryesore në nivel urbanistik janë:

a) Ristrukturimi urbanistik

Është e kuptueshme që të verifikohet dhe më pas të korrigjohet aty ku nuk ka logjikë, në raport me strukturën territoriale ose urbane me të cilën ai formon njësinë si të tërë. Me rëndësi të veçantë është analiza e rolit territorial dhe funksional që qendra historike ka kryer në të shkuarën dhe në të tashmen. Një kujdes i veçantë në këtë kuptim i jepet analizës dhe ristrukturimit (raportet ekzistuese mes qendrës historike dhe zhvillimeve urbanistike e ndërtimeve bashkëkohore, mbi të gjitha nga këndvështrimi funksional sidomos në përputhje me funksionet administrativo-sociale). Ristrukturimi urbanistik duhet të ketë qëllim lirin e qendrave historike nga ato destinacione funksionale, teknologjike dhe nga të gjitha funksionet e tjera, që provokojnë një efekt kaotik dhe degradues tek ato.

b) Riorganizimi në vazhdimësi

Kjo i referohet analizës dhe rishikimit të vazhdueshëm të lidhjeve të ndryshme dhe fluksit të trafikut që përfshijnë strukturën me qëllim reduktimin e patologjive të tilla dhe ridrejtimin e përdorimit të qendrave historike në përputhje me funksionet e dikurshme. Por, duhet konsideruar këtu, mundësia e futjes dhe përdorimit të pajisjeve dhe atyre shërbimeve publike të lidhura ngushtë, me nevoja të domosdoshme të jetës së përditshme të qendrës historike.

c) Rishikim i harmonizimit urban

Kjo përfshin rrugët, sheshet dhe të gjitha hapësirat e lira të jashtme (kopshte, hapësira të lira, parqe, etj), me qëllim krijimin e një lidhje homogjene mes ndërtesave dhe hapësirave të jashtme. Tipat kryesorë të ndërhyrjeve në nivel ndërtues janë:

1. Përmirësimi statik dhe pamor i ndërtesave, duke ruajtur strukturën dhe përdorimin e ekuilibruar të tyre.

Kjo ndërhyrje kryhet sipas teknikave, modaliteteve dhe udhëzimeve që kryhen edhe restaurimet arkitektonike. Në këtë lloj restaurimi ka rëndësi të madhe respektimi i cilësive tipologjike, konstruktive dhe funksionale të ansamblit/veprës, duke evituar ato transformime që tjetërsojnë karakteret.

2. Rinovimi i brendshëm funksional i ndërtesave.

Edhe në këtë tip ndërhyrjeje ka rëndësi respektimi i ekuilibrit dhe cilësisë tipologjike dhe konstruktive të ndërtesave, duke ndaluar ato ndërhyrje që tjetërsojnë dhe deformojnë karakteret.

Instrumentet operuese:

- plane të përgjithshme rregulluese, që rregullojnë raportet mes qendrës historiko-territoriale dhe qendrës historike e qytetit si një të tërë;

- plane të hollësishme që lidhen me ristrukturimin e qendrës historike në elementët e saj më domethënës;

- plane ekzekutive të veçanta, të shtrirë në zona të izoluara ose në një bashkësi elementësh të grupuar në mënyrë organike.

SHTOJCA E RREGULLA PËR KONSERVIMIN DHE RESTAURIMIN E LIBRIT

Përpara se të fillohet me operacione të restaurimit në këtë fushë, duhet marrë në konsideratë vepra në kompleksitetin dhe larminë e saj historike, artistike, materiale dhe funksionale.

Në rastet kur objekte të trashëgimisë kulturore janë librat, duhet marrë në konsideratë përbërja e tyre materiale si letër, pergamenë, papirus ose ndonjë material tjetër mbi të cilin shkruhet si, dru, metal, karton, lëkurë, spango, pëlhurë, etj.

Njohja e origjinës së çdo materiali është e domosdoshme për të proceduar me korrektësi operacionin e restaurimit, ashtu siç është i domosdoshëm edhe studimi i materialeve “të reja” që do të përdoren në librat që do të restaurohen.

Ndërhyrjet duhet të kushtëzohen nga hetimet që kryhen nga ekspertët duke filluar që nga bibliotekari (historia e librit, e dekoracionit, rëndësia e veprës, etj), tek biologu, teknologu, fizikani dhe restauratori.

Në bibliotekat duhen kryer studime mbi gjendjen e konservimit të fondeve të librave, duke i rilevuar sistematikisht për vlerat termoigrometrike ambientale dhe për tu siguruar se ruajnë limitet e kushteve ambientale. (Temperatura 16 -20 gradë , Lagështia 40-65) .

Kur lind nevoja operohet si me përmirësimin e kushteve klimatike të ambienteve ashtu edhe me ndërhyrjet për konservimin dhe restaurimin e librave të veçantë. Në këtë operacion parashikohen mjete alternative (mikrofilma, mikrofisha, videodisqe) me qëllim ruajtjen edhe në mënyra të tjera të veprës. Operacionet e restaurimit duhet të paraprihen nga dezinfektimi ose dezinfektimet e volumeve të veprave kur këto paraqesin tjetërsime me origjinë biologjike.

Në skedën e restaurimit duhet të regjistrohen veçanësitë e çdo libri dhe duhen përshkruar në mënyrë të detajuar dëmtimet që paraqiten, si dhe ndërhyrjet e mëparshme. Duhet përshkruar gjithashtu edhe operacionet që do të kryhen për të arritur rezultatet e pritshme, me qëllim perfeksionimin e metodave të ndjekura më parë.

Në rast të një ndërhyrje restauruese në vepër duhet zgjedhur mes: ndërhyrjes së plotë ose të pjesshme. Rasti i ndërhyrjes së pjesshme aplikohet për restaurimin e librave që nuk paraqesin probleme në lidhje (nuk janë të shqepur), atëherë kur veprat janë me interes të veçantë për strukturën e tyre, lashtësinë, vlerën artistike, si edhe në rastet kur vlerësohet se nuk mund të operohet në mënyrë radikale.

Ndërhyrja në këto raste reduktohet në minimum dhe libri nuk pëson tjetërsime për shkak të çmontimit të plotë, duke mbajtur të paprekshme karakteristikat origjinale të strukturimit.

Në rastet kur është e nevojshme shqepja e librit, duhet ndërhyrë me kujdes të veçantë për të evituar humbjen e ndonjë dëshmie (flete).

Përpara se të shqepet një libër, duhen kontrolluar numrat për të evituar gabimet gjatë rikompozimit të fashikujve. Çdo lloj anomalie shënohet nga bibliotekari përgjegjës. Nuk procedohet gjithnjë me të njëjtin kriter për çdo libër që restaurohet, sepse librat mund të kenë karakteristika e veçanti që kërkojnë edhe ndërhyrje të llojeve të ndryshme.

Rregulli kryesor në restaurim është të evitohen të gjitha operacionet që mund të tjetërsojnë pamjen dhe vlerën e përgjithshme të veprës (librit). Për këtë arsye, duhet të kryhet konservimi i çdo elementi të veçantë. Libri duke qenë një objekt që preket, hapet, manipulohet, duhet të jetë funksional në përdorimin e tij. Kështu që në disa raste lidhja origjinale mund të mos imitohet, për shkak të mosprakticitetit në përdorim të librit.

Për fletët parashikohet të përcaktohet përqindja e tretshmërisë së bojës dhe ngjyrave përpara se të procedohet me çfarëdo lloj operacioni “në lagështirë” (larje, përdorim ngjyësish, fiksuesish, etj).

Të tilla operacione duhen kryer vetëm nëse është e domosdoshme dhe duhen ndjekur nga afër. Këshillohen të gjitha masat parandaluese, të cilat ndihmojnë që në fazën e lavazhit të mos humbë asnjë fragment. Sidomos të këshillueshme janë përdorimi i telajos ose retinos.

Pas lavazhit vazhdohet me ngjitjen e fletëve. Nëse fletët kanë nevojë për një shtresë të pjesshme apo të plotë, parashikohet që kjo të bëhet me një pëlhurë letre japoneze transparente por rezistente, me një penel shumë të butë dhe me një ngjitës riversibël.

Një moment i rëndësishëm është presimi ose ngjeshja e fletëve, e nevojshme për ti dhënë pamjen origjinale sipërfaqes së fletës. Në çdo rast nuk duhet kryer ngjeshje e fortë dhe kjo arrihet duke përdorur pllaka mermeri. Kur kjo ngjeshje nuk është e mjaftueshme, duhet përdorur “presimi me goditje” por gjithnjë duke kontrolluar forcën. Gjatë këtij proces duhen ruajtur të gjitha relievat ose zgavrat që gjenden nëpër fleta. Nuk restaurohen, vizatimet ose të tjera shënime, sepse konsiderohen pjesë e historisë së librit.

Është për t’u konsideruar ruajtja e librave në kuti, ose mjete të tilla të ngjashme, kur shihet e nevojshme. Kjo për një konservim sa më të mirë të librit.

Për pergamenën principet e restaurimit janë të njëjta me ato të letrave, vetëm se për lavazhet, të cilat përdoren vetëm në raste shumë të domosdoshme, përdoret një përzierje alkooli etilik me ujë. Ngjeshja, e cila duhet të jetë vetëm “shtendosje”, kryhet me pllakëza dhe me tirante të vegjël.

Në gjithë këto operacione libri konsiderohet si një vepër arti në kuptimin më të gjerë të fjalës, si vlerë kulturore e ndërthurur me tekst, si vlerë materiale, si vlerë artistike. Për këtë arsye, çdo rast duhet trajtuar si një rast më vete.

Për sa i përket konservimit të librit modern duhen marrë parasysh disa sugjerime. Kriteret bazë janë ato të konservimit të librave antikë. Librat e prodhuar në shekullin XIX e më pas janë me një cilësi më të dobët se ato të periudhave paraardhëse. Lënda e parë antike ishte më e pastër duke paraqitur shpesh një mbrojtje natyrale ndaj aciditetit për shkak të pranisë së substancave alkaline në brumin e letrës. Si rrjedhojë e lëndëve me përbërje acide që përdoren, letra rezulton më e lehtë por më e vështirë për tu ngjitur. Si rrjedhojë e përdorimit në vitet ‘800 të brumit prej druri me përmbajtje lignine, rezulton një rënie e ndjeshme e cilësisë së letrës, e cila për këtë arsye rezulton e dobët, e ashpër dhe shumë e prekshme nga nxirja.

Për të gjitha këto arsye që thamë, udhëzohet që në çdo rast, përpara restaurimit të një libri, të kryen kërkime dhe studime të përshtatshme për llojin dhe përbërjen e letrës së përdorur.

Rekomandimi i fundit është për bibliotekarët që duhet të vlerësojnë gjithnjë me kujdes urgjencën dhe nevojën e restaurimit të një libri, duke e konsideruar atë (restaurimin) si masë ekstreme dhe duke e evituar atë, sa më shumë që të jetë e mundur nëpërmjet masave parandaluese që shmangin degradimin e librit.

SHTOJCA F

RREGULLA PËR KONSERVIMIN DHE RESTAURIMIN E MATERIALEVE TË ARKIVIT.

Restaurimi i dokumenteve të arkivit duhet të kryhet vetëm në rastet kur është dëmtuar rëndë struktura fizike e dokumenteve arkivore gjë që rrezikon vërtetësinë e dëshmive historike. Restaurimi fillon gjithnjë vetëm pasi të jenë verifikuar shkaqet e degradimit të dokumenteve.. Për shkak të rëndësisë së veçantë dhe vlerave historike, politike dhe juridike të dokumenteve arkivore të ruajtura nga subjekte shtetërore apo private, çdo operacion konservimi ose restaurimi duhet të kryhet pasi të jetë dhënë më parë garanci mbi integritetin e informacioneve që

përmbajmë dokumentet. Për këtë arsye, çdo ndërhyrje restaurimi në dokumentet arkivore duhet të motivohet me shkrim nga drejtuesit e arkivave, sipas përgjegjësiwe përkatëse institucionale.

Kërkesa për restaurim duhet të përmbaje një përshkrim analitik të degradimit të dokumentit së bashku me shkaqet, i shoqëruar në çdo rast me dokumentacion fotografik. Kërkesat për restaurime me rëndësi të veçantë, me specifika karakteristike, të lidhjeve, formateve etj, duhen aprovuar më parë nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të Shtetit.

Ndërhyrja për restaurim, operacionet që do ndërmerren, metodologjitë që do ndiqen, pajisjet, solucionet dhe materialet që do përdoren, duhet të parashikohen dhe përshkruhen në detaje në kartelën përkatëse. Restaurimi duhet të ruajë origjinalitetin e dokumentit në raport me formën, strukturën, dhe çdo element tjetër të origjinalit.

Ndërhyrja restaurimit duhet të jetë reversibël. Bashkimi i pjesëve që mungojnë duhet kryer me sy të lirë.

Janë të lejuara ndërhyrjet, vetëm kur janë shumë të domosdoshme, dhe vetëm kur janë të motivuara nga nevojat e një konservimi të mëvonshëm.

Duhen hequr të gjithë elementet e shtuara, që në rrjedhën e kohës, kanë tjetërsuar në mënyrë abuzive origjinalitetin e dokumentit. Lejohet përdorimi i pajisjeve që lejojnë restaurimin mekanik të dokumenteve prej letre, gjithnjë vetëm pas vlerësimit të kujdesshëm të gjendjes së konservimit dhe stabilitetit të ndërmjetësve grafikë.

Restaurimi në të gjitha fazat e operimit, duhet të dokumentohet dhe përshkruhet në mënyrë të detajuar, për sa i përket metodave të ndjekura, pajisjeve dhe materialeve të përdorura.

Ndërhyrjet e restaurimit duhen udhëhequr nga personel i kualifikuar pranë laboratorëve përkatës. Produktet dhe materialet që përdoren (ngjitës, fiksues, solucionet, letra, lëkurë, etj) duhet ti përshtaten kushteve fizike për rezistencë, stabilitet, jetëgjatësi etj.

Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave të Shtetit ushtron kompetenca mbikëqyrjeje në vendet ku kryhen këto restaurime për të verifikuar përshtatshmërinë dhe konformitetin e ndërhyrjes me normat teknike.

Si rrjedhim, pas restaurimit, kushtet e konservimit, të udhëzuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të Shtetit, duhen respektuar në mënyrë skrupuloze duke kryer kontrolle të përsëritura në ambientin në të cilat janë sistemuar dokumentet dhe në vetë dokumentet.

VENDIM
Nr.723, datë 14.5.2008

PËR PËRBËRJEN E KOMITETIT KOMBËTAR TË TRASHËGIMISË KULTURORE
SHPIRTËRORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 6 të ligjit nr.9048, datë 7.4.2003 "Për trashëgiminë kulturore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komiteti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Shpirtërore të kryesohet nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe në përbërje të ketë:

- drejtorin e drejtorisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore sekretar;
- përgjegjësin e sektorit për trashëgiminë shpirtërore, anëtar;
- një specialist për trashëgiminë shpirtërore pranë ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore anëtar;
- drejtorin e Qendrës Kombëtare të Veprimtarive Kulturore anëtar;
- drejtorin e departamentit të kulturës popullore në Qendrën Kombëtare të Albanologjisë anëtar;
- një specialist të departamentit të kulturës popullore në Qendrën Kombëtare të Albanologjisë anëtar;
- drejtorin artistik të ansamblit të këngëve dhe valleve popullore anëtar;
- sekretarin e Komitetit Kombëtar të UNESCO-s pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme anëtar.

2. Ngarkohet ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UDHËZIM
Nr.446, datë 5.7.2007

PËR MIRATIMIN E DOKUMENTEVE STANDARDE TË KONKURRIMIT PUBLIK
PËR RESTAURIMIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës dhe në zbatim të pikës 2, kreu V të vendimit nr.216, datë 18.4.2007 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e konkurrimit publik, për përzgjedhjen e subjekteve të licencuara për restaurimin e monumenteve të kulturës”, Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve;

UDHËZON:

1. Institucionet publike të përcaktuara në pikën 2 të kreut I të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.216, datë 18.4.2007, të cilat nëpërmjet procedurave të konkurrimit publik, vënë në dispozicion fonde nga Buxheti i Shtetit për realizimin e restaurimeve të objekteve/monumenteve të trashëgimisë kulturore, prej subjekteve të licencuara për këtë qëllim, duhet të përdorin dokumentet standarde të restaurimit, të miratuara sipas formularëve bashkëlidhur këtij udhëzimi.

2. Në vendimin nr.216, datë 18.4.2007 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e konkurrimit publik, për përzgjedhjen e subjekteve të licencuara për restaurimin e monumenteve të kulturës”, afatet e dorëzimit të ofertave dhe shqyrtimit të ofertave nga Komisioni duhet të përlllogariten si më poshtë:

a) Në kreun II, pika 3, shkronja “d”, data e dorëzimit të ofertave duhet të jetë jo më parë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data e njoftimit të konkurrimit në Buletinin e Njoftimeve Publike.

b) Në kreun II, pika 3, shkronja “e”, data e mbledhjes së Komisionit për shqyrtimin e ofertave duhet të jetë jo më vonë se 3 (tre) ditë nga dorëzimi i ofertave.

c) Të gjitha afatet në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.216, datë 18.4.2007 duhet të përlllogariten në ditë kalendarike.

3. Në vendimin nr.216, datë 18.4.2007 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e konkurrimit publik, për përzgjedhjen e subjekteve të licencuara për restaurimin e monumenteve të kulturës”, pika 4.ç), subjektet të cilat kualifikohen sipas dokumentacionit ligjor të kërkuar sipas rastit në dokumentet standarde të restaurimit, i

nënshtrohen kriterëve vlerësuese për përzgjedhjen e ofertës më të mirë ekonomike. Oferta më e mirë ekonomike do të konsiderohet, ajo e cila merr numrin më të madh të pikëve, vlerësuar sipas kriterëve të mëposhtme:

a) Oferta ekonomike me vlerën më të ulët të ofruar do të marrë 85 pikë, ofertat ekonomike pasardhëse ulen me nga 5 pikë secila, sipas rendit zbritës.

b) Eksperienca e subjekteve konkurrues, që mund të jenë:

- shoqëri restauruese;

- shoqëri ndërtimi – me nënkontraktorë restaurator;

- individë restaurues

do të vlerësohet deri në 15 pikë.

Kriteret vlerësuese për përzgjedhjen e ofertës më të mirë ekonomike, lidhur me eksperiencën dhe të dhënat tekniko-profesionale parashikohen në dokumentet standarde të konkurrimit, në varësi të objektit që do të restaurohet, madhësisë së fondit të vënë në dispozicion, shkallës së vështirësisë së projektit.

Nëse me të njëjtën sasi pikësh rendit e para më shumë se një ofertë, njësia e vlerësimit vendos me shumicë votash, për ofertën më të mirë ekonomike të ofruar, mbështetur në kriteret e vlerësimit të përmendura në pikën 3 të këtij udhëzimi. Vendimi i Komisionit për ofertën më të mirë ekonomike duhet të jetë i argumentuar.

4. Në vendimin nr.216, datë 18.4.2007 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e konkurrimit publik, për përzgjedhjen e subjekteve të licencuara për restaurimin e monumenteve të kulturës”, pika 5, oferta ekonomike do të paraqitet nga subjektet konkurruese pa TVSH. Shpallja e fondit limit të objektit që do të restaurohet bëhet në vlerën e plotë pa TVSH.

5. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për publikimin e këtij udhëzimi dhe dokumenteve standarde të restaurimit, në formë elektronike në faqen e internetit të kësaj ministrie.

6. Ngarkohen institucionet e përcaktuara në pikën 2 të kreut I të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.216, datë 18.4.2007 apo institucione të tjera të autorizuar nga Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për zbatimin e këtij udhëzimi.

7. Ndryshimet dhe shtesat në këtë udhëzim miratohen nga Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, me propozim të institucioneve të përcaktuara në pikën 1 të këtij udhëzimi, si dhe të strukturës përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, në Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I TURIZMIT, KULTURËS,
RINISË DHE SPORTEVE
Ylli Pango

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS,
RINISË DHE SPORTEVE**

**DOKUMENTE STANDARDE TË RESTAURIMIT
TË OBJEKTEVE TË TRASHËGIMISË KULTURORE**

DOKUMENTET STANDARDE TË RESTAURIMIT

1. Njoftim për publikimin e restaurimit
2. Ftesa për ofertë e restaurimi
3. Preventivi i ofertës
4. Të dhënat e restaurimit
- 5 Projekti i restaurimit, skica dhe specifikimet teknike
6. Grafiku për kryerjen e restaurimeve
7. Kërkesa për kualifikim dhe kriteret për vlerësim
8. Sigurimi i ofertës
9. Sigurimi i kontratës
10. Kushtet e kontratës së restaurimit
11. Njoftimi i fituesit
12. Udhëzimet për kandidatët pjesëmarrës në konkurrim publik

Emri i institucionit:

Data: _____

FORMULARI I NJOFTIMIT TË KONKURRIMIT PUBLIK
PËR RESTAURIM

1. Institucioni

njofton subjektet e interesuara të licencuara për restaurim të marrin pjesë me ofertat e tyre publike në konkursin publik të shpallur nga ky institucion.

2. Objekti që do të restaurohet është _____ dhe ndodhet në _____

3. Fondi limit i vënë në dispozicion është _____

4. Data e përfundimit të restaurimit _____ ditë, nga data e lidhjes së kontratës.

5. Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është data _____, ora _____, ne zyrën e protokollit të institucionit. Ofertat e paraqitura pas këtij afati do të refuzohen.

6. Kandidatët e interesuar mund të inspektojnë dokumentet e restaurimit, nga ora _____ deri _____, pranë zyrës së _____

7. Dokumentet standarde të restaurimit mund të tërhiqen pranë institucionit në bazë të kërkesës me shkrim dhe kundrejt një çmimi prej _____ lekë, nga ora _____ deri _____.

8. Ofertat duhet të shoqërohen nga dokumente ligjorë dhe administrative origjinale ose kopje të noterizuara si provë e kërkesave kualifikuese të përcaktuara në dokumentat standarde të restaurimit, të miratuara për këtë qëllim.

9. Ofertat do të shqyrtohen nga komisioni i vlerësimit në datë _____, ora _____ në zyrën e _____

10. Përfaqësues të autorizuar me shkrim të ofertuesve janë të ftuar të ndjekin hapjen e ofertave.

Drejtuesi i institucionit

(nëshkrimi, vula)

FORMULARI I OFERTËS SË RESTAURIMIT

Data: _____

Për: _____

Unë (Ne), të nënshkruarit, deklarojmë se:

(a) Kemi egzaminuar dokumentet e restaurimit për konkurim të tërhequra pranë institucionit që zhvillon procedurat e konkurimit publik, e paraqesim këtë ofertë pa rezervime ose përjashtime për kërkesat ose afatet dhe kushtet e shprehura këtu.

(b) Ne ofrojmë të mbarojmë restaurimin e _____

siç specifikohet në Dokumentet e Restaurimit dhe në perputhje me Grafikon e Realizimit të restaurimeve të paraqitur në dokumentat e restaurimit.

(c) Çmimi total i ofertës sonë është _____ lekë

(shuma me shifra dhe fjalë)

(Të jepet vlera e ofertës pa TVSH).

(d) Oferta jonë do të jetë e vlefshme për periudhën e specifikuar në të Dhënat të Ofertës. Kjo periudhë nis nga data e fiksuar si afat i fundit për paraqitjen e ofertave. Gjatë kësaj periudhe, kjo ofertë do të mbetet e vlefshme ndaj nesh dhe mund të pranohet në çdo kohë përpara skadimit të asaj periudhe.

(e) Nëse oferta jonë pranohet, ne do të japim sigurimin e kontratës në masën 10% në shumën prej _____ lekë, siç

(shuma me shifra dhe fjalë)

kërkohet nga Dokumentat e Restaurimit.

(f) Ne nuk marrim pjesë si ofertues në më shumë se një ofertë në këtë konkurim publik.

(k) Ne e kuptojmë se ju, institucioni publik, nuk jeni të detyruar të pranoni çdo ofertë që merrni dhe se ju keni të drejtën të anuloni këtë konkurim pa shpallur asnjë fitues.

Emri: _____

Firma:

Vula:

Në _____

cilesinë

e: _____

I autorizuar siç duhet të nënshkruajë ofertën për dhe në emër të: _____

(emri i subjektit)

Data _____

PREVENTIVI I OFERTËS SË RESTAURIMIT

TABELA SHOQËRUESE E OFERTËS EKONOMIKE

Nr.	Lloji i punimit	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlefëta
1.					
2.					
3.					
4.					
5.					
6.					
7.					
8.					
9.					
10.	Shuma				
	Fondi rezervë 20%				
	TOTALI				

Detyrimet tatimore do t'i shtohen subjektit fitues në momentin e lidhjes së kontratës së restaurimit të objektit.

(emri,mbiemri,shoqeria)

TË DHENAT E RESTAURIMIT PREZANTIM

1 Institucioni që zhvillon procedurën e konkurrimit publik të restaurimeve është:_____

2. Adresa e institucionit është:_____

3. Objekti i restaurimit është: _____

4. Vendndodhja është: _____

5. Personi i kontaktit për institucionin është:

Emri: _____

Titulli: _____

Adresa: _____

Telefoni: _____
Faks: _____
e-mail: _____

6. Subjektet konkurrentë lejohen të vizitojnë dhe këqyrin objektin që do të restaurohet duke ndërmarrë kostot dhe rrisqet e vizitës.

7. Oferrat do të dorëzohen në zyrën e protokollit të institucionit.

Afati i fundit i dorëzimit të ofertave është:

Data: _____

Ora: _____

TË DHËNA PËR PËRGATITJEN DHE PARAQITJEN E OFERTËS

1. Gjuha e ofertes duhet të jetë: shqip ose një gjuhë tjetër e specifikuar

2. Konkurrentët paraqesin vetëm 1 (një) zarf me dokumente të cilët duhet të jenë origjinale ose kopje të noteruara të tyre në përputhje me kërkesat për kualifikim dhe vlerësim të kërkuara nga insitucioni që zhvillon konkurrimin publik të restaurimit.

3. Zarfi i dokumenteve duhet të jetë i mbyllur, i vulosur, dhe mbi të duhet të jenë të shkruara:

“Ofertë publike për restaurimin e

_____”
(emri i objektit)

Për _____
Emrin e institucionit dhe adresa

Emri i subjektit privat ofertues _____

Adresa: _____

Telefoni: _____

Faks: _____

e-mail: _____

4. Formulari Standard i Ofertës, duhet të plotësohet pa gabime dhe korrigjime dhe të nënshkruhet prej përfaqësuesit ligjor të subjektit konkurrues. Oferta duhet të jetë e mbyllur në një zarf më vete, por brenda zarfit të përcaktuar në pikën 3, dhe sipër tij të shkruhen fjalët “Ofertë ekonomike e restaurimit të objektit _____” (vlera pa TVSH). Edhe ky zarf duhet të jetë i nënshkruar dhe vulosur nga subjekti ofertues.

5. Përvec sa parashikohet në Kërkesat për Kualifikim dhe Kriteret për Vlerësim, të dokumenteve të restaurimit, Ofertuesi konkurrent duhet të paraqesë bashkë me ofertën edhe:

a. Sigurimin e Ofertes në masën 2% - 5 % të fondit të vënë në dispozicion për restaurim të shpallur në njoftimin publik të konkurrimin publik: përkatësisht në shumën _____ Lekë.

b. Sigurimi i ofertës do të pranohet në format e mëposhtme:

garanci bankare ose nga shoqëritë e sigurimit të licencuara në RSH.

c. Periudha e vlefshmërisë së ofertës do të jetë: 60 ditë nga data e hapjes së

Ofertave.

d. Çmimet të shprehen në monedhën shqiptare Lekë

C. HAPJA E OFERTAVE

1. Hapja dhe shqyrtimi i Ofertave do të bëhet nga komisioni i vlerësimit të institucionit në:

Datë: _____

Ora: _____

2. Përfaqësues të autorizuar me shkrim të ofertuesve konkurrentë paraqesin dhe një mjet identifikimi, që konfirmon prezencën e tyre në datën e hapjes dhe shqyrtimit të ofertave dhe dokumentave kualifikues të subjekteve konkurrentë.

3. Në rast të mosparaqitjes së autorizimit dhe të një mjeti identifikues, personi që përfaqëson ofertuesin nuk legjitimohet të marrë pjesë në datën dhe orën e caktuar nga komisioni për shqyrtimin e ofertave.

Megjithatë pas afatit të mësipërm, ofertuesi ka të drejtë të disponojë një kopje të procesverbalit të datës së hapjes dhe shqyrtimit të ofertave të komisionit, kundrejt kërkesës me shkrim drejtuar kryetarit të komisionit të konkurrimit.

Përpara hapjes dhe shqyrtimit të ofertave anëtarët e komisionit duhet të deklarojnë se nuk kanë konflikt interesi me pjesëmarrësit. Për këtë ata nënshkruajnë me përgjegjësi të plotë deklarata individuale që mbajnë datën e zhvillimit të konkurrimit publik.

D. KËRKESAT E KUALIFIKIMIT

1. Që një ofertë restaurimi të pranohet, konkurrenti ofertues duhet të paraqesë dokumentat ligjorë e administrativë, në përputhje me pjesën I-rë të Kërkesave për Kualifikim. Mosplotësimi i çdonjërës nga kërkesat e parashikuara në dokumentet standarde të kërkuar, përbën shkak për skualifikim të subjektit konkurrent dhe refuzim të vlerësimit të ofertës së paraqitur.

2. Përveç se provon kualifikimin e subjektit, paraqitja e dokumentave ligjorë e administrativë, provon gjithashtu se subjekti është në gjendje të zbatojë këtë kontratë restaurimi.

3. Në çdo rast të konstatimit apo verifikimit se dokumentat e paraqitura janë të rreme apo të fallsifikuara, atëherë komisioni përveç se e skualifikon subjektin që ka paraqitur këto dokumente, i propozon Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve: përjashtimin nga pjesëmarrja në proceduar të konkurrimit publik për një periudhë nga 1 vit deri në 2 vjet; ose heqjen e licensës së restaurimit; dhe/ose i kërkon organeve kompetente fillimin e procedimit penal ndaj subjektit fallsifikues.

4. Dokumentat e paraqitur duhet të jenë origjinale ose kopje të noteruara, jo më vonë se tre muaj nga data e hapjes së ofertave, shpallur në njoftimin publik.

5. Përfaqësues të autorizuar me shkrim të kandidatëve konkurrentë, paraqesin përveç autorizimit edhe një mjet identifikimi.

KRITERET E VLERËSIMIT

1. Komisioni i vlerësimit të ofertave lexon me zë të lartë në prani të konkurrentëve ofertat ekonomike si cmim total, si dhe dokumentacionin ligjor. Më pas komisioni kalon në shqyrtimin e detajuar të tyre me qëllim përzgjedhjen e ofertës më të mirë ekonomike.

2. Pas shqyrtimit të gabimeve aritmetike të ofertave, komisioni vlerësues

bën vlerësimin e tyre në bazë të Kriterëve të Vlerësimit, të përcaktuar në pikën 3 të udhëzimit të Ministrit të Turizmit Kulturës Rinisë dhe Sporteve, "Për miratimin e dokumenteve standarte të konkurimit publik për restaurimin e monumenteve të kulturës", si dhe në dokumentat standarde të restaurimit.

3. Komisioni bën vlerësimin e ofertave, krahasimin dhe kalsifikimin e tyre, duke përdorur kriterin dhe metodologjinë e mëposhtme të vlerësimit:

Oferta ekonomike me vlerën më të ulët të ofruar do të marrë 85 pikë, ofertat ekonomike pasardhëse ulen me nga 5 pikë secila, sipas rendit zbritës.

Eksperienca e subjekteve konkurrese, që mund të jënë:

shoqëri restauruese,

shoqëri ndertimi – me nenkontraktore restauratore,

individe restaurues;

do të vlerësohet deri në 15 pikë.

F. SHQYRTIMI ADMINISTRATIV

F.1 Konkurenti ofertues ka të drejtë të kërkojë shqyrtim administrativ të veprimeve ose neglizhimeve të institucionit që zhvillon procedurat e konkurimit publik.

F.2 Ankesat e drejtuara entit të konkurimit duhet të dërgohen tek:

F.3 Ankesat e drejtuara organit qendror duhet të dërgohen tek Ministria e Turizmit, Kulturës Rinisë dhe Sporteve, Tiranë.

F.4 Vendimi i Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve është përfundimtar dhe kundër tij bëhet ankim në gjykatë.

F.5 Ankesat e drejtuara institucionve të autorizuar nga ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, për zhvillimin e konkurimit i drejtohen Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Vendimi i tij është përfundimtar dhe kundër tij bëhet ankim në gjykatë.

PROJEKTI I RESTAURIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE

1. Titulli i projektit _____ i

2. Emri i objektit/objekteve _____ i

3. Vendndodhja e objektit/objekteve _____ e

4. Projekti i Restaurimit, të miratuar nga Këshilli Kombëtar të Restaurimit me vendimin Nr _____, Datë _____/ _____

5. Skicimet, Planimetritë e objektit që do të restaurohet etj i bashkëlidhen:

6. Specifikimet teknike të materialeve dhe mjeteve të punës për restaurimet:

7. Kriteret e ndrëhyrjeve restauruese dhe shërbime të tjera në lidhje me to:

8. Të tjera:

GRAFIKU I REALIZIMIT TË PUNIMEVE TË RESTAURIMIT

Punimet e restaurimit do të kryhen për _____ ditë nga data e lidhjes së kontratës dhe sipas zërave të projektit të miratuar.

Nëse projekti është i hartuar në faza punimesh përcakto fazat. Për çdo fazë hartohet një situacion në përputhje me projektin e miratuar.

1. Faza e parë:
2. Faza e dytë:
3. Faza e tretë etj.:
4. Inspektimi dhe kontrolli i punimeve të restaurimit
5. Përfundimi i punimeve të restaurimit dhe dorëzimi i tyre.
6. Të tjera: _____

KËRKESAT PËR KUALIFIKIM DHE KRITERET PËR VLERËSIM

I. KËRKESAT LIGJORE-ADMINISTRATIVE PËR KUALIFIKIM

a. Vendim për regjistrim në gjykatë si person fizik/juridik, si dhe Statuti dhe akti i themelimit të shoqërisë për p.juridik

b. Certifikatë tatimore e pesonit fizik/juridik dhe NIPT i shoqërisë.

c. Vërtetim nga gjykata që subjekti nuk është në proces gjyqësor që lidhet me aktivitetin e tij

ç. Vërtetim që subjekti prokuroria që subjekti nuk është në proces penal që lidhet me aktivitetin e tij.

d. Vërtetim nga dega e tatim-taksave që subjekti i ka shlyer detyrimet tatimore dhe sigurimet shoqërore për _____vetë.

e. Subjekti person fizik/juridik, duhet të jetë i pajisur me Licencë për restaurim, të pajisur nga Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe sipas nenit 17, te ligjit 9048, dt.07.04.2003, "Për trashëgiminë kulturore" të ndryshuar (kopje të Licencës).

Kërkesat e Përgjithshme për Kualifikim provohen me dokumentat që janë leshuar jo më vonë se 3 muaj nga dita e hapjes së ofertave.

Dokumentat të jenë origjinale apo kopje të noterizuara. Mosparaqitja e njerit prej dokumentave të mesipër, deklaratimet jo të sakta apo të rreme, janë kusht skualifikues.

Secili anëtar i një bashkimi të perkohshëm shoqëror duhet të paraqesë dokumenta që provojnë se ai i plotëson kërkesat e përgjithshme të listuara më sipër.

II. KRITERET E VLERËSIMIT TË OFERTAVE

Do të vlerësohet me pikë më shumë, subjekti i cili paraqet besueshmëri dhe të dhëna tekniko profesionale.

Eksperienca të mëparshme të subjekteve konkurrues, qe mund te jene:

- 1) shoqëri restauruese,
- 2) shoqëri ndertimi – me nenkontraktore restauratore,
- 3) individe restaurues;
- 4) të cilat do të provohen me kontrata të ngjashme, a vërtetim të punimeve të restaurimit, referenca, patentat, experienca te vleresuara, specializime apo trajnime e te tjera të cilat provojnë besueshmëri në fushën e restaurimeve apo dokumente të tjera të cilat provojnë këtë eksperiencë. Dokumentacioni i paraqitur duhet të jetë fotokopje e noteruar.

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS SË RESTAURIMIT

GARANCI BANKARE / SIGURACION

Nr.....

Data_____/____/_____

Me këtë dokument vërtetojmë se _____ka
derdhur (emri i pjesëmarrësit në
konkurrim) pranë_____ shumën prej

(emri i bankës, adresa) (shuma ne shifra dhe
fjalë)

si kusht për sigurimin e ofertës së paraqitur në konkurrimin publik për restaurimin e

(emri i objektit te konkurrimit)

_____merr përsipër të kalojë në
llogarinë e

(banka / shoqëria e sigurimit)

_____këtë garanci bankare /siguracion, në rast
se:

(emri i institucionit publik)

1. Pjesmarrësi në konkurrim publik tërheq ofertën pa mbaruar afati i vlefshmërisë së ofertës.

2. Heq dorë nga lidhja e kontratës së restaurimit, nëse shpallet fitues.

3. Nuk paraqet garancinë e kontratës brenda afatit të kërkuar dhe shpallur nga institucioni publik.

Me paraqitjen e kërkesës së parë me shkrim nga ana e institucionit publik, pa kërkuar shpjegime, me kusht që në kërkesë të përmendet mosplotësimi i një prej

kushteve të mësipërme.

Kjo garanci është e vlefshme deri në datën që përfshin 30 ditë nga mbarimi i afatit të vlefshmërisë së ofertës.

Nënshkrimi dhe vula e Bankës/Shoqërisë së Sigurimit

FORMULARI I SIGURIMIT TË KONTRATËS SË RESTAURIMIT

GARANCI BANKARE/ SIGURACION

Nr. _____

Data _____/_____/_____

Për : _____

Emri dhe Adresa e Institucionit publik

- Duke qenë se _____ është shpallur
fitues për

(emri i kontraktuesit)

lidhjen e kontratës së restaurimit me objekt

(pershkrim i shkurtër i objektit të
kontrates)

- Duke qenë se në kushtet e lidhjes së kontratës së restaurimit kërkohet
Garanci Bankare/ Sigurim në shumën e specifikuar në të, si sigurim për
permbushjen e detyrimeve të parashikuara në kontratë:

- Duke qenë se _____ është dakord të
leshojë këtë

(emri i bankës/shoqërisë së sigurimit)

garanci në masën 10% të vlerës së ofertës së shpallur fituese;

- Deklarojmë se ne jemi garantuesit e kontrates së mesipërme deri në shumën
totale prej

_____ lekë, shume e cila është e
pagueshme në (shuma në shifra dhe fjalë)
menyren dhe monedhen e përcaktuar në kontratë.

- Ne marrim përsipër të paguajmë, sapo të bëni kërkesën e parë me shkrim
dhe pa qenë nevoja të bëni argumentim të kërkesës, cdo shume brenda kufirit prej
_____ Lekë

(shuma e garancisë).

-Me kete garanci ju sigurojme se nuk eshte nevoja t'i drejtoheni me pare Kontraktuesit per te realizuar pagesen sipas kerkeses suaj.

-Deklarojme gjithashtu, se asnje shtese apo ndryshim i kushteve te kontrates, per te cilen ju mund te bini dakord me kontraktuesin, nuk na cliron nga detyrimet e kesaj Garancie.

-Kjo garanci eshte e vlefshme deri ne daten qe perfshin 30 dite nga data e leshimit te Certifikates se Perfundimit të punimeve të restaurimit.

Nenshkrimi dhe Vula e Bankes/Shoqerise se Sigurimit

NJOFTIMI I FITUESIT PËR RESTAURIMET

Data:

Emri i institucionit:_____

Emri i subjektit fitues:_____

lajmëron

(Emri i institucionit)
Fitues)

(emri dhe adresa e subjektit

se Oferta e paraqitur më datë _____ për kryerjen e restaurimit të objektit

_____ për shumën totale prej_____

(emri dhe përshkrim i përgjithshëm i restaurimeve)

_____Lekë është pranuar.

(shuma në shifra dhe fjalë)

Subjekti fitues_____ kërkohet t'i paraqesë_____

(emri i institucionit)

Sigurimin e Kontrates të përcaktuar në Dokumentet e Restaurimit, brenda datës_____.

Në rast se terhiqeni nga lidhja e kontrates duhet te njoftoni me shkrim brenda dates se mesiperme dhe sigurimi i ofertës së konkurrimit publik kalon për llogari të institucionit_____.

(emri i institucionit)

.....
Drejtuesi i institucionit
(emri, firma dhe vula)

KUSHTET E KONTRATËS SË RESTAURIMIT

Të objekteve të trashëgimisë kulturore

Neni 1: Zbatimi i kuadrit ligjor

1. Ligji nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore” të ndryshuar, vendimi nr.216, datë 18.4.2007 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e konkurimit publik, për përzgjedhjen e subjekteve të licensuar për restaurimin e monumenteve të kulturës” dhe dispozitat e Kodit Civil të RSH, për kontratat.

Neni 2. Përkufizime

1. “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Institucionit publik që zhvillon konurrimin publik e që vë në dispozicion fondin për restaurim, dhe dhe Kontraktuesit që përbëhet nga dokumentat e restaurimit duke përfshirë të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti standart të restaurimeve.
2. “Institucioni publik” do të thotë institucioni publik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate porosit Punime restaurimi.
3. “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet e restaurimit.
4. “Objekti i kontratës” do të thotë të gjitha Punimet e restaurimit që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës, ku përfshihet cdo ndërhyrje që bëhet në objektin e trashëgimisë kulturore, me qëllim mirëmbajtjen e tij dhe përmirësimin e gjendjes së tij fizike, në përputhje me projektin e miratuar nga Këshilli Kombëtar të Restaurimeve, më tej KKR.
5. “Çmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës së restaurimit për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontakte sipas kushteve të rëna dakort.
6. “Preventiv per njesi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.
7. “Data e fillimit” eshte data kur kontraktuesi do te filloje punimet e restaurimit. Ne se kjo nuk realizohet , “data e fillimit “do te jete dita ne te cilen do te paguhet paradhenia.
8. “Data e realizimit te punimeve të restaurimit” do të thotë data që Punimet e restaurimit duhet të perfundojne siç është shprehur në Grafikun për realizimin Punimeve te restaurimitt, sipas Projektit të Restaurimit të miratuar nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve.
9. “Realizimi i punimeve restauruese” do të thotë Akti administrativ, me anë të cilit Institucioni kontraktues vërteton se Restaurimi është përfunduar nga Subjekti i Kontraktuar, në përputhje me projektin e miratuar nga KKR.
10. “Drejtues projekti” do të thotë personi i autorizuar nga Instituti i Monumenteve të Kulturës për mbikqyrjen e punimeve restauruese, i

cili është përgjegjës për administrimin e kontratës për Institucionin publik.

11. "Standarde teknike të restaurimit" do të thotë specifikimet dhe kriteret e restaurimit, të aprovuara dhe të miratuara në dokumentat e restaurimit, të tilla që i referohen dispozitave, parimeve, rregullaave dhe udhëzimeve të Kartës Shqiptare të Restaurimeve.
12. "Nënkontaktues" do të thotë çdo person fizik ose juridik privat, që furnizon Punimet e restaurimit, materialet ose pajisjet për ose në emër të Kontraktuesit.

Neni 3: Formimi i Kontratës

1. Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë formimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e restaurimit.
2. Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar/bashkëngjitur:
 - a) njoftimin e fituesit,
 - b) formularin e sigurimit të kontratës,
 - c) formularin e ofertës fituese
 - d) dhe/ose cdo marrveshje e rënë dakort midis palëve

Neni 4: Sigurimi i Kontrates

1. Sigurimi i kontrates në shumën prej 10% të vlerës së Kontrates duhet të ofrohet nga Kontraktuesi për të siguruar egzekutimin e detyrimeve të tij sipas kontratës, ashtu sic përcaktohet në dokumentat e restaurimit.
2. Sigurimi i kontrates do të lëshohet ose kthehet, Kontraktuesit 30 ditë pas marrjes në dorëzim të objektit.
 - 5 % e vlerës së Kontratës do të ngurtësohet para marrjes në dorëzim të veprës dhe do lirohet subjektit kontraktues pas 12 muajve nga lëshimi i certifikatës së pranimit të punimeve.
3. Sigurimi i kontratës mund të bëhet edhe nëpërmjet shoqërive të sigurimit. Në këtë rast shoqëria e sigurimit nëpërmjet sigurimit të kontratës mbulon cdo dëmtrim të interesave të institucionit nga subjekti kontraktues gjatë zbatimit të kontratës.

Neni 5: Drejtuesi-mbikqyrës i Projektit

1. Drejtuesi i projektit është Mbikqyrësi i punimeve të restaurimit i autorizuar me shkrim nga Instituti i Monumenteve të Kulturës.
2. Autorizimi me shkrim i Institutit të Monumenteve të Kulturës është dokument që i bashkëlidhet kontratës së restaurimit.
3. Drejtuesi i projektit do të vendosë për çështjet e kontratës midis Kontraktuesit dhe Institucionit publik. Për cdo çështje Drejtuesi mban korrespondencë të datuar me shkrim, të cilat i bashkëngjiten kontratës gjatë zbatimit të saj.
4. Drejtuesi i Projektit mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjerët përveç zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve. Drejtuesi i projektit duhet të njoftojë Kontraktuesin për delegimet e bëra dhe ato të anuluar.

Neni 6: Inspektimet dhe Testimet

1. Inspektimet dhe testimet para vërtetimit të mbarimit të Restaurimeve do të përfshijnë: Punimet restauruese të kryera sipas projektit të kërkuar dhe miratuar nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve.
2. Testimet dhe inspektimi perfundimtar firmoset patjetër nga Mbikqyesi i autorizuar dhe Drejtuesi i Institucionit, dhe nga përfaqësuesi i autorizuar i subjektit kontraktues që kryen punimet restauruese.
3. Me shpenzimet e tij, Institucioni publik ka të drejtë të ndjekë testimet dhe/ose inspektimet. Nëse materialet prodhohen ose përgatiten në vende të ndryshme nga ato të Kontraktuesit, Kontraktuesi duhet të marrë leje për Institucionin publik që të ndjekë këto teste dhe inspektime.
4. Institucioni publik gjithashtu mund t'i kërkojë Kontraktuesit të bëjë teste ose inspektime shtesë të pa parashikuara në kontratë por të gjykuara të nevojshme për të verifikuar se Restaurimet janë konform specifikimeve dhe kushteve të kontratës. Institucioni publik do të mbajë përgjegjësi për koston e këtyre testeve. Më tej, nëse këto teste ndalojnë progresin e punës së Kontraktuesit, Institucioni publik do të bëjë dakort të ndryshojë grafikun.
5. Institucioni publik do të refuzojë çdo Punim restaurimi që nuk e kalon testimin dhe/ose inspektimin ose nuk është konform specifikimeve teknike dhe kushteve të kërkuara në zbatimin e kontratës.
6. As ekzekutimi i testeve as inspektimi i Punimeve të Ndërtimit nuk do të lirojë Kontraktuesin nga çdo garanci ose detyrim tjetër sipas kontratës.

Neni 7: Lloji dhe çmimi i Kontratës

1. Kontrata e Restaurimi do të çmohet si një Kontratë me Çmim Njesie të bazuar në çmimet e njesise të shprehura në Preventivin në Njesi.
2. Kontrata do të përfshijë një Preventiv për Njesi në një kontratë me çmim njesie. Preventivi për Njesi do të përmbajë volumet e zerave të restaurimit.
3. Preventivi për Njesi do të përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës. Kontraktuesi do të paguhet për sasinë e realizuar me tarifën në Preventivin në Njesi për secilin ze punimesh.
4. Çmimi total i Kontratës së Restaurimit do të përbëhet nga totali i preventivit sipas përcaktimit në paragrafët e mësipërm, fondin rezervë prej 20%, dhe detyrimet fiskale të llogaritur sipas legjislacionit për tatim-taksat në RSH.

Neni 8: Grafiku i pagesës

Pagesa duhet bërë sipas grafikut të mëposhtëm dhe në bazë të situacioneve:

1. Me paraqitjen e situacionit, subjekti kontraktues i bëhet pagesa sipas situacioneve të paraqitura në 3 (tri) kopje. Situacionet nënshkruhen nga mbikqyrësi i punimeve të restaurimeve dhe përfaqësuesi i ngarkuar i shoqërisë dhe drejtuesi i institucionit që ka lidhur kontratën e restaurimit.
2. Pagesa e çdo situacioni Restaurimi duhet bërë brenda 20 ditëve, nga paraqitja e situacionit në zyren e financës së institucionit që ka lidhur

kontratën.

3. Monedha e pagesës do të jetë në monedhën Shqiptare - Lekë.

Neni 9: Pagesa paraprake

1. Kontraktuesi do të marrë pagesë paraprake vetëm nëse palët e parashikojnë në kontratën e lidhur midis tyre një gjë të tillë.
2. Në se është parashikuar një pagesë paraprake, përqindja e pagesës paraprake do të jetë 10% e vlerës totale të kontratës, dhe do t'i paguhet Subjektit Kontraktues paguhet brenda 10 ditëve nga lidhja e kontrates midis palëve.

Në se jepet pagesa paraprake, shuma do të hiqet nga pagesa që duhet t'i jepet Kontraktuesit sipas formulës së mëposhtme:

10% e Situacionit të paraqitur, nënshkruar e pranuar nga palët, sic parashikohet në grafikun e realizimit të punimeve të restaurimit.

Neni 10:Praktikat e Korruptuara, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

1. Institucioni publik mund t'i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën në se zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime të korruptuara.
2. Kontraktuesi duhet të lejojë Institucionin publik të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t'i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Institucioni publik.

Neni 11: Informacioni Konfidencial

1. Kontraktuesi dhe Institucioni publik duhet të mbajnë në kofidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
2. Kontraktuesi mund t'i japë nën-Kontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Institucioni publik deri në masën e kërkuar që nën-Kontraktuesin të zbatojë vetëm punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nën-Kontraktuesin një dispozitë që premteton ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 1 më sipër.
3. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Kontraktuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i paraqesë Institucionit publik të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikën, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Institucioni publik.

Neni 12: Kontrolli paraprak i Materialeve që përdoren për restaurim

1. Në cdo rast Mbikqyrësi i punimeve të restaurimit ka për detyrë të kontrollojë materialet që subjekti Kontraktues do të përdorë për restaurim, të cilat duhet të jenë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuar në dokumentat standarte të restaurimit.
2. Në rast të konstatimit në kundërshtim me paragrafin 1, mbikqyrësi

ndërpret punimet, vë në dijeni Drejtuesin e institucionit publik dhe detyron subjektin Kontraktues të zbatojë kushtet e kontratës dhe të dokumentave standarte të restuarimit.

3. Në rast se përdorimi i materialeve jo të duhura për restaurim është konstatuar pas punimeve, atëherë subjekti kontraktues njoftohet për kompesimin e dëmit të shkaktuar objektit, sipas sanksioneve të vendosura në kontratën e restaurimit.

Neni 13: Komunikimi:

Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim. Data e njoftimit do të quhet data e marrjes dijeni të njoftimit, të konfirmuar respektivisht nga palët ose përfaqësuesit e tyre.

Neni 14: Mbarimi i Punimeve të Restaurimit

1. Kontraktuesi duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë sapo ta lidhi atë dhe duhet t'i mbarojë Restaurimet brenda Datës së Mbarimit.
2. Palët mund të vendosin me marrëveshje të dyanshme shtyrjen e afatit të mbarimit të punimeve të restaurimit, vetëm nëse:
 - a) kjo është e argumentuar dhe i shërben cilësisë dhe garantimit të qëndrueshmërisë së objektit që restaurohet.
 - b) Pë shkak të forcave madhore të cilat pengojnë në mënyrë direkte përfundimin e punimeve të restaurimit.

Neni 15: Detyrimi për mbrojtjen dhe sigurinë e punimeve të restaurimit dhe zonës së mbrojtur të objektit që restaurohet.

Kontraktuesi do të mbajë përgjegjësi për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në objektin që restaurohet dhe zonën e mbrojtur përreth tij sipas dispozitave të ligjit "Për trashëgiminë kulturore"

Neni 16: Zbulimet

Çdo gjë me interes historik ose me vlerë të konsiderueshme e zbuluar papritur në zonën e mbrojtur të objektit ose në truallin nën të, bëhet pronë e Institucionit publik. Kontraktuesi duhet të njoftojë drejtuesin e projektit për ndonjë zbulim të tillë dhe të ndjekë udhëzimet e drejtuesit të projektit për procedurën e ndjekjes me objektet, sipas dispozitave të ligjit "Për trashëgiminë kulturore" dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Për këtë duhet të mbahet procesverbal i cili nënshkruhet ngë palët.

Neni 17: Kontrolli i cilësisë

1. Kontraktuesi do të jetë plotësisht përgjegjës për kontrollimin e cilësisë dhe zbatimin e kontratës.
2. Sapo të lidhë kontratën, Kontraktuesi duhet t'i paraqesë drejtuesit të projektit një plan për kontrollin e cilësisë së aktiviteteve në zbatimin e kontratës.
3. Drejtuesi i projektit duhet të kontrollojë punën e Kontraktuesit dhe të njoftojë Kontraktuesin për defekte që mund të jenë gjetur. Sa herë që të jepet njoftimi për defekte, Kontraktuesi duhet të korrigjojë defektin brenda kohëzgjatjes së parashikuar në njoftim.
4. Në se Kontraktuesi nuk e ka korrigjuar një defekt brenda kohës së specifikuar në njoftimin e defektit nga drejtuesi i projektit, drejtuesi i projektit do të llogarisi koston e korrigjimit të defektit dhe kjo shumë

do të mbahet nga çdo pagesë që i duhet bërë Kontraktuesit deri sa defekti të korrigjohet.

5. Dështimi për të korrigjuar defektin brenda një afati të arsyeshëm përbën bazë për ndërprerje për mosplotësim sipas të drejtës së Institucionit publik.

Neni 18: Garancitë

1. Kontraktuesi garanton se materialet e trupëzuara me Restaurimet janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuar nga institucioni publik në dokumentat standarte të restaurimit dhe trupëzojnë përmirsimet e objektit që restaurohet.
2. Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë ose nga ligji, Kontraktuesi garanton se materialet nuk kanë defekte të shkaktuara nga ndonjë veprim ose mosveprim i Kontraktuesit ose të shkaktuara nga skicimi, materialet dhe puna nën kushte normale përdorimi në kushtet që mbizotërojnë në Shqipëri.

Neni 19: Çmimi i kontratës

Çmimet e Kontraktuesit për Restaurimet e kryera sipas kontratës nuk duhet të ndryshojnë nga çmimet e ofruara nga Kontraktuesi në ofertën e tij.

Neni 20: Kushtet e pagesës

1. Çmimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat paraprake, duhet të paguhet siç specifikohet në kontratën e lidhur mes palëve.
2. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet më një dispozitë tjetër të kontratës, pagesa do të bëhet me monedhë Shqiptare. Kursi i shkëmbimit të monedhave të ndryshme do të jetë kursi i Bankes së Shqipërisë i 28 ditëve para datës së hapjes së Ofertave.
3. Kontraktuesi duhet të paraqesë një deklaratë me situacionin e punimeve drejtuesi i projektit që deklaron se rezultati për atë fazë punimi është arritur. Komunikata gjithashtu duhet të shprehë vlerën e punës së egzekutuar duke hequr shumën e grumbulluar të verifikuar më parë, si dhe shumën e pagesës paraprake të papaguar dhe çdo shumë të mbajtur në pritje të korrigjimit të një defekti.
4. Drejtuesi i projektit duhet të kontrollojë Restaurimet e egzekutuara nga Kontraktuesi dhe duhet të verifikojë shumën që duhet t'i paguhet Kontraktuesit brenda 20 ditëve pune nga data që Kontraktuesi paraqet komunikatën e tij tek drejtuesi i projektit.
5. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet me një dispozitë tjetër të kontratës, pagesa e progresit për Restaurimet do të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga data që progresi i Restaurimeve është verifikuar nga drejtuesi i projektit.
6. Data e pagesës do të jetë dita që fondet preken nga llogaria e Institucionit publik.

Neni 21: Vonesa në bërjen e pagesës

1. Shperblimi për demet e shkaktuara si rezultat i vonesës në pagesë konsistojnë në kamaten e arritur nga data e fillimit të vonesës së debitorit (Institucionit publik), në monedhën që do të bëhet pagesa. Përqindja e kamates parashikohet me ligj. Në fund të çdo viti kamatat

e arrira i shtohen shumës totale, mbi të cilën është bërë llogaritja e tyre.

2. Kamata ligjore paguhet pa qene i detyruar kreditori (Kontraktuesi) te provoje ndonje dem. Në se kreditori (Kontraktuesi) provon se ka pesuar nje dem me te madh se kamata ligjore, debitori (Institucioni publik) duhet të paguajë pjesën e mbetur të demit.

Neni 22: Nryshimi i ligjeve dhe rregulloreve

Në se pas datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj, rregullore, urdhëresë, urdhër ose procedurë me efektin e ligjit në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi, nxirret ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit, ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa Kontraktuesi është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

Neni 23: Forca madhore

1. Kontraktuesi nuk duhet të mbajë përgjegjësi për ndërprerjen për mosplotësim në se dhe deri në masën që vonesa në zbatim ose ndonjë dështim tjetër në zbatimin e detyrimeve të tij sipas kontratës, vijnë si rezultat i ndodhjes së Forcës Madhore.
2. Për qëllimet e këtij neni “Forcë Madhore” do të thotë një ngjarje jashtë kontrollit të Kontraktuesit për fajin ose neglizhimin dhe e paparashikueshme. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk janë të limitizuara nga, veprimet e Institucionit publik qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, zjarri, përmbytja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo tranziti.
3. Në se ndodh ndonjë situatë e Forcës Madhore, Kontraktuesi duhet të njoftojë menjehere Institucionin Publik. Me përjashtim kur Institucioni publik jep direktiva të ndryshme, Kontraktuesi duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin që nuk pengohet nga Forca Madhore.

Neni 24: Vonesa në zbatim dhe zgjatja e afatit

1. Me përjashtim kur parashikohet ndryshe, Kontraktuesi duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë pas nënshkrimit të saj.
2. Institucioni publik do të jetë dakort për një zgjatje të afatit në rastin e Forcës Madhore.
3. Institucioni publik mund të jetë dakort për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera në se është në interesin publik për ta bërë këtë. Në rast se Kontraktuesi ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, Kontraktuesi duhet të njoftojë menjehere Institucionin publik me shkrim për vonesën, shkaku dhe datën e propozuar të dorëzimit ose përfundimit. Institucioni publik duhet të vlerësojë kërkesën. Në se Institucioni publik është dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga Institucioni publik dhe Kontraktuesi.

Neni 25: Likuidimi i dëmeve për vonesën në mbarimin e punimeve te restaurimit

1. Dëmet e likuiduara për vonesën në mbarimin e Restaurimeve do të llogariten me tarifat e mëposhtme ditore:

2. Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 e çmimit total të kontratës.
3. Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 e çmimit total të kontratës.
4. Për kontratat me periudhë zbatimi më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 1/1000 e çmimit total të kontratës.

Neni 26: Negociatat dhe amendamentet

1. Palët nuk do të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë elementi të kontratës që do të ndryshontë mjaftueshëm kushtet që përbëjnë bazën e përzgjedhjes së Kontraktuesit.
2. Asnjë amendament ose variacion tjetër i kontratës nuk do të jetë i vlefshëm pa qënë me shkrim, me datë, i referohet shprehimisht kontratës dhe nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar i Kontraktuesit dhe Drejtuesi i Institucionit publik.
3. Çdo heqje dore nga të drejtat, pushtetet ose ndreqjet që mund të bëhen nga palët sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim, të ketë datë dhe të firmoset nga një përfaqësues i autorizuar i palës që bën këtë dorëheqje dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën në të cilën ajo lëshohet.

Neni 27: Ndryshimi i porosisë

1. Kushtet e kontratës nuk janë subjekt rinegociimi dhe amendimi pas hyrjes në fuqi me përjashtim kur lejohet specifikisht dhe parashikohet në kushtet e kontratës. Çdo amendament i kontratës duhet të bëhet me shkrim dhe firmosur nga Institucioni publik dhe Kontraktuesi.
2. Punime restaurimi shtesë mund të porositen me kusht që rritja e çmimit të kontratës të mos i kalojë 30% të çmimit origjinal të kontratës.
3. Punimet shtesë duhet të jenë konform cmimeve për njësi për zëra punimesh të ngashme të ofruara nga kontraktuesi në Ofertën e Restaurimit.
4. Çmime më të larta se ato të ofruara në ofertën e resaturimit nuk aplikohen, me përjashtim të atyre zërave të cilat nuk janë të specifikuara në preventiv-ofertë nga institucioni publik, dhe me kushtin që të arrihet rezultati i pritshëm i restaurimit të objektit. Në këtë Drejtuesi I Institucionit publik miraton shtesën dhe amendimet e porosisë së ndryshuar duhet të trupëzohen në amendamentet e marrveshjes, të lidhur midis palëve.

Neni 28: Mbarimi dhe marrja përsipër e restaurimeve

1. Kontraktuesi duhet t'i kërkojë drejtuesit të projektit t'i lëshojë një certifikatë për mbarimin e Restaurimevedhe drejtuesi i projektit do t'a bëjë këtë sapo të vendosi se Restaurimet janë mbaruar plotësisht.
2. Në se drejtuesi i projektit zbulon se Restaurimet nuk janë përfunduar plotësisht, drejtuesi i projektit do t'i japi udhëzime me shkrim Kontraktuesit që specifikojnë zerrat e punimeve ose aktivitetet që duhen përfunduar para se të lëshohet certifikata e Përfundimit të Restaurimeve.
3. Në se drejtuesi i projektit zbulon defekte në Restaurime, drejtuesi i projektit duhet t'i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim duke

specifikuar defektet që duhet të korrigjohen para se të lëshohet certifikata e Përfundimit të Restaurimeve.

Neni 29: Ndërprerja e kontratës

1. Institucioni publik mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht në se:
2. Kontraktuesi dështon në kryerjen e Restaurimeve brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë; ose,
3. Kontraktuesi dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.
4. Institucioni publik duhet t'i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotësim dhe t'i japi Kontraktuesit 15 ditë të ndreqë mosplotësimin me përjashtim kur ndërprerja është bërë për veprime të korruptuara ose të paligjshme, në të cilin rast ndërprerja do të jetë e menjëhershme.
5. Nëse Kontrata ndërpritet për mosplotësim të kushteve të saj, të gjitha materialet dhe Restaurimet e trupëzuar deri në atë moment do të bëhen pronë e Institucionit publik.
6. Institucioni publik mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë në se Kontraktuesi falimenton ose bëhet i paaftë të paguajë dhe për këtë Institucioni publik duhet t'i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim për ndërprerjen.
7. Institucioni publik mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë në se gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik., ta njoftojë me shkrim për ndërprerjen, si dhe të paguajë Kontraktuesin për të gjitha Restaurimet e pranuar dhe të kryera përpara ndërprerjes dhe duhet t'i paguajë Kontraktuesit dëmet e shkaktuara për kryerjen e pjesshme të Restaurimeve. Në llogaritjen e shumës së dëmeve, Kontraktuesi do të kërkohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.

Neni 30: Nënkontraktimi

1. Një nën-kontratë do të jetë e vlefshme vetëm në se është në formën e një marrveshjeje të shkruar me anë të së cilës Kontraktuesi i beson kryerjen e një pjese të detyrimeve të kontratës së tij një pale të tretë.
2. Kontraktuesi nuk duhet të nënkontrakttojë pa aprovimin paraprak me shkrim të Institucionit publik. Kontraktuesi duhet të njoftojë Institucionin Publik për elementet e kontratës që nën-kontraktohet dhe identitetin e nën-Kontraktuesit. Institucioni publik duhet të lajmërojë Kontraktuesin për vendimin e tij, brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke shprehur arsyet në se e aprovon apo jo atë.
3. Cdo nenkontraktues duhet të ketë të drejtë të marre pjese në konkurrimin publik sipas Ligjit mbi Konkurrimin Publik.
4. Kur kontraktuesi ka ndërmend të realizojë një pjesë të punimeve me nenkontraktues, duhet të paraqesë në ofetë, sipas dokumentave të restaurimit, gjithë dokumentacionin e kërkuar për nenkontraktuesit si dhe për punimet konkrete që do të japë me nenkontraktim.

Neni 31: Përfaqësimi i palëve

1. Çdo palë duhet të emërojë me shkrim një person ose strukture

organizative, që do të jetë përgjegjës, në emër të palës, për marrjen e komunikatave dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me egzekutimin e kontratës.

2. Secila palë duhet të lajmërojë palën tjetër menjëherë për ndonjë ndryshim në emërimin e përfaqësuesit të palës. Në se njëra palë dështon të lajmërojë, duhet të marri përsipër çdo humbje të shkaktuar nga dështimi për të dhënë njoftim të mjaftueshëm.
3. Palët mund të emërojnë persona ose struktura organizative shtesë për të përfaqësuar palën në veprime ose veprimtari të veçanta në të cilin rast njoftimi me shkrim duhet dhënë dhe duhet të përcaktojë shtrirjen e autoritetit të përfaqësuesit.

Neni 32: Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Institucioni publik dhe Kontraktuesi duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrëveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë marrëveshje, me anë të negociatave direkte. Negociimi duhet të provohet vetëm në bazë të komunikimit me shkrim midis palëve.
2. Në se palët dështojnë në negociatat për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ose konfliktit, problemet do të konsiderohen dhe zgjidhen, sipas përcaktimeve në kontratën midis palëve dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit në fuqi të Republikës së Shqipërisë.

PROJEKTI I RESTAURIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE

1. Titulli i projektit _____ i
2. Emri i objektit/objekteve _____ i
3. Vendndodhja e objektit/objekteve _____ e
4. Projekti i restaurimit, të miratuar nga Këshilli Kombëtar të Restaurimit me vendimin nr _____, datë _____/ _____
5. Skicimet, planimetritë e objektit që do të restaurohet etj, i bashkëlidhen këtij formulari dhe janë _____ fletë
(numrii fletëve në shifra dhe fjalë)
6. Specifikimet teknike të Materialeve që do të përdoren për restaurim:
7. Specifikimi dhe përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to, në përputhje me parimet, rregullat dhe udhëzimet e Kartës Shqiptare të Restaurimeve:

PREVENTIVI I OFERTËS SË RESTAURIMIT

TABELA SHOQËRUESE E OFERTËS EKONOMIKE

Nr.	Lloji i punimit	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlefte
1.					
2.					
3.					
4.					
5.					
6.					
7.					
8.					
9.					
10.	Shuma				
11.	Fondi rezervë 20%, për punime restaurimi të paparashikuara në projekt-preventiv				
12.	TOTALI (pa TVSH)				

(emri, mbiemri, shoqëria)

Vlerës totale të mësipërme do t'i shtohen të gjitha detyrimet tatimore sipas legjislacionit shqiptar në fuqi për tatim-taksat, vetëm në momentin e lidhjes së kontratës së restaurimit të objektit të subjektit ofertues me institucionin publik

GRAFIKU I REALIZIMIT TË PUNIMEVE TË RESTAURIMIT

Punimet e restaurimit do të kryhen për _____ ditë nga data e lidhjes së kontratës dhe sipas zërave të projektit të miratuar.

1. Faza e parë
2. Faza e dytë
3. Faza e tretë
4. Inspektimi dhe kontrolli i punimeve të restaurimit
5. Certifikata e përfundimit të punimeve të restaurimit

UDHËZIME PËR KANDIDATËT QË MARRIN PJESË NË KONKURRIMIN PUBLIK PËR RESTAURIMET E OBJEKTEVE TË TRASHEGIMISË KULTURORE

I. TË PËRGJITHSHME

1. Prezantimi

1.1 Me paraqitjen e ofertes, ofertuesi pranon në mënyrë të plotë të gjitha afatet dhe kushtet e dokumentave të restaurimit dhe heq dorë nga kushtet e zbatimit të vetë ofertuesit. Çdo klauzolë në oferte në kundërshtim me këtë nuk do të quhet ose do të cojë në refuzimin e ofertes.

1.2 Ofertuesit duhet të egzaminojnë me kujdes dhe të respektojnë të gjitha udhëzimet, format, kushtet, specifikimet dhe kërkesat e përfshira në dokumentat e restaurimit. Në rast të ndonjë mosperputhje midis ose ndërmjet pjesëve të dokumentave të restaurimit, ofertuesit duhet të kërkojnë sqarim nga enti i konkurrimit.

1.3 Mosparaqitja e ofertes para afatit të fundit për paraqitjen e ofertave do të rezultojë në refuzimin e ofertes.

1.4 Mosdhënia brenda afatit të gjithë informacionit dhe dokumentacionin e kërkuar mund të rezultojë në refuzimin e Ofertes.

2. Veprimet e Jashteligjshme

2.1 Institucioni publik duhet të refuzojë një oferte, në rast se kandidati që e bën atë jep ose premtim të jape drejtperdrejt ose terthorazi, cdo zyrtari të tanishëm apo të mëparshëm ose nepunesi të institucionit publik a organeve të tjera, një shperblim në formë, një punësim ose cdo shërbim apo vleftë, si stimul për një akt, vendim ose procedure që do të ndermarre institucioni publik lidhur me procedurat e konkurrimit.

3. Konflikt Interesi

3.1 Një ofertues nuk duhet të ketë konflikt interesi. Çdo ofertues që zbulohet të ketë konflikt interesi do të skualifikohet. Një ofertues mund të konsiderohet të ketë konflikt interesi me një ose më shumë palë të konkurrimit nëse ofertuesi:

- Dorëzon më tepër se një oferte në këtë konkurrim, me përjashtim të ofertave alternative;

- Është i lidhur me një person fizik ose juridik, i ngarkuar nga institucioni

publik të siguroje shërbimë këshilluese për pregatitjen e skicimit, specifikimeve dhe dokumentave të tjerë që do të përdoren për konkurrimin e Punimeve të Ndërtimit që do të realizohen në këtë konkurrim.

3.1 Ndërmarrjet shtetërore në Shqipëri mund të marrin pjesë në një procedurë konkurrimi vetëm nëse ato janë ligjërisht dhe financiarisht autonome, nëse ato operojnë sipas të drejtës tregtare dhe nëse ato nuk janë agjensi e varur nga institucioni publik.

3.2 Anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave nuk duhet të kenë lidhje pune, gjaku ose interesash me asnjë ofertues. Për këtë arsye, anëtari i komisionit duhet të leshojë një deklaratë perkatese përpara hapjes së ofertave.

4. Kualifikimi i Ofertave

4.1 Një person fizik apo juridik do të skualifikohet nga procedura e konkurimit nëse ai nuk plotëson Kërkesat për Kualifikim dhe nuk paraqet dokumentacionin e kërkuar si provë të kualifikimeve të tij të përcaktuara në grupin I, të Kërkesave për Kualifikim.

4.2 Kërkesat e kualifikimit do të zbatohen në mënyrë të barabartë për të gjithë kandidatët.

4.3 Asnjë person fizik apo juridik nuk do të përjashtohet nga pjesëmarrja në këtë konkurrim për shkak të shtetësisë.

4.4 Institucioni publik duhet të skualifikojë një kandidat, i cili për kualifikimin e tij paraqet një dokument që përmban informacion të rremë. Paraqitja e një dokumenti të rremë mund të përbëjë shkak që e ndalon kandidatin të marrë pjesë në çdo konkurrim publik për një periudhë prej një deri në tre vjet.

4.5 Institucioni publik duhet të skualifikojë një kandidat, nëse konstaton në çdo kohë deri në nënshkrimin e kontratës, që informacionet e paraqitura lidhur me kualifikimin ose të dhënat që kanë lidhje me vlerësimin e kandidatit, janë të pasakta ose jo të plota.

4.6 Një bashkim i perkohshëm shoqëror mund të marrë pjesë në konkurrim nëse plotëson kushtet e mëposhtme:

- Egziston një kontratë, e noterizuar midis të gjithë personave fizikë dhe/ose juridikë të bashkimit të perkohshëm të shoqërive e firmosur nga të gjithë anëtarët përpara afatit të fundit të paraqitjes të ofertave që përcakton detyrimet e secilit anëtar në zbatimin e kontratës dhe thotë se secili anëtar është dakort t'i përmbahet ofertes bashkarisht dhe vec e vec.

- Oferta firmoset nga një përfaqësues i bashkimit të perkohshëm të shoqërive që është autorizuar shprehimisht me shkrim nga të gjithë anëtarët e këtij bashkimi, të urdhërojnë këtë bashkim dhe gjithë anëtarët e saj.

- Çdo anëtar i bashkimit të perkohshëm të shoqërive duhet të plotësojë kërkesat e kualifikimit të konkurimit dhe duhet të paraqesë të gjitha dokumentat e kërkuara administrative dhe ligjore.

5. Egzaminimi i objektit që do të restaurohet

1 Kandidati ofertues që ka paraqitur interes për të marrë pjesë në konkurrimin publik restaurimin lejohet të vizitojë dhe egzaminojë objektin që do të restaurohet, si dhe rrethinat e tij me shpenzimet e tij dhe të sigurojë gjithë informacionin që mund të jetë i nevojshëm për pregatitjen e ofertës dhe lidhjen e kontratës për realizimin e Restaurimeve.

6. Sqarimi i Dokumentave të Restaurimit dhe modifikimi

1. Një kandidat kërkon sqarime mbi dokumentat e restaurimit duhet të njoftojë me shkrim institucionin publik me shkrim, duke përfshirë këtu posten, faksin, e-mail, në adresën e specifikuar në Të Dhenat e Restaurimit.
2. Ky institucion publik do t'i përgjigjet me shkrim çdo kërkesë për sqarime që mund të marrë brenda afateve kohore. Kopje me shkrim të përgjigjes nga enti i konkurrimit do t'i dërgohen menjehere të gjithë personave fizikë dhe juridik që kanë blerë dokumentat e restaurimit.
3. Nëse do të mbahet një takim sqarues, ai do të njoftohet konkurrenteve me shkrim, në adresën, në datën dhe në orën e detajuar në Të Dhenat e Restaurimit. Mungesa në takimin sqarues nuk do të përbëjë shkak për refuzimin e Ofertes. Një kopje e procesverbalit të takimit do t'i vihet në dispozicion çdo kandidati që e kërkon.
4. Institucioni publik, në çdo kohë përpara mbarimit të afatit të fundit të paraqitjes së ofertave, me iniciativën e tij ose në përgjigje të një kërkesë nga një kandidat që ka blerë dokumentat e restaurimit, mund t'i modifikojë ato duke hartuar një shtojcë, e cila bëhet pjesë perberese e dokumentave të restaurimit.
5. Çdo shtojcë duhet t'i njoftohet menjehere çdo kandidati që ka blerë dokumentat e restaurimit. Institucioni publik duhet të dokumentojë këtë njoftim.
6. Nëse institucioni publik e konsideron të nevojshme të modifikojë dokumentat e restaurimit dhe modifikimi njoftohet subjekteve që kanë blerë dokumenta, dhe mund të shtyjë datën e zhvillimit të konkurimit publik me jo më shumë se 5 ditë nga data e publikuar në fillim.
7. Njoftimi në këtë rast publikohet vetëm në Buletinin e Njoftimeve Publike.

7. PËRGATITJA E OFERTAVE

1. Gjuha e ofertës: Oferta do të shkruhet në gjuhën e përcaktuar në të dhënat e ofertës.
2. Monedha

Çmimet të shprehen në monedhën e përcaktuar në Të Dhënat e Ofertes. Kursi i këmbimit të monedhave të ndryshme, për efekt krahasimi ofertash, do të jetë kursi i Bankes së Shqipërisë i 28 ditëve përpara hapjes së ofertës.

8. Përbërja e ofertës

- Oferta e pregatitur dhe e paraqitur nga ofertuesi do të firmoset nga ofertuesi dhe do të përfshijë dokumentat e mëposhtme:

- Formularin e Ofertës të firmosur nga ofertuesi, të futur në një zarf, sic përcaktohet në të dhënat e ofertës. Ky formular duhet të plotësohet në të gjitha vendet bosh pa ndryshuar formatin.

- Formularin e Preventivit të plotësuar me cmime, sipas zërave dhe bashkëngjitur me Ofertën;

- Listën e të gjithë dokumentave ligjorë/administrativë të kërkuar në Formularin e Kërkesave për Kualifikim dhe Vlerësim.

- Specifikimet teknike

- Grafikon e kryerjes se punimeve te restaurimit.
- Autorizim shkrim per perfaqsim te ofertuesit
- Sigurimi i ofertes

9. Informacion për çmimin

1. Ofertuesi duhet të sigurojë një përshkrim të shkurtër të punimeve te ndertimit që do të kryhen dhe shërbimeve në lidhje me to.
2. Të gjitha çmimet e ofruara duhet të jenë te sakta dhe jo subjekt rishikimi.
3. Të gjitha çmimet e ofruara duhet të jenë bazuar në çmimin e preventivit per njesi (kontratat me punime ne matje) të paraqitura nga ofertuesi.
4. Ofertuesi duhet të plotësojë çmimet dhe tarifat për të gjitha zerat e punimeve te ndertimit të përshkruara në preventiv.
5. Të gjitha tarifat, taksat dhe detyrimet e tjera që duhet të paguajë ofertuesi për të kryer Restaurimet nuk duhet të përfshihen në tarifat, çmimet dhe çmimin total të Ofertes të paraqitur nga ofertuesi. Ato llogariten në çmimin e kontratës
6. Ofertuesi duhet të tregojë gjithashtu edhe:
 - a) Çmimin Total të Ofertes pa TVSH
 - b) Çdo informacion tjetër të kërkuar në dokumentat e restaurimit

10. Sigurimi i pershtatshmerise së punimeve te restaurimet dhe shërbimeve në lidhje me to

1. Kërkesat e detajuara për Punimet e restaurimit dhe shërbimet në lidhje me to shprehen në dokumentat e restaurimit.
2. Punimet e ofruara duhet që në çdo drejtim të plotësojnë kërkesat e paraqitura në dokumentat e restaurimit.
3. Kur kërkohet në dokumentat e restaurimit, planimetritë, skicimet, literatura përshkruese, udhezimet, manualët, katalogët, broshurat ose fletëpalosjet për materialet dhe Punimet e ofruara duhet të shoqërojnë oferten. Këto duhet të jenë në gjuhën e shprehur në të Dhënat e Ofertës.

11. Periudha e vlefshmërisë së ofertave

1. Pas kalimit të afatit për paraqitjen e ofertave, ofertat do të mbeten të vlefshëm dhe në fuqi për ofertuesin për kohën e specifikuar në dokumentat e restaurimit. Në se një oferte thotë se është e vlefshme për një periudhe kohe më të shkurtër ajo duhet të refuzohet.
2. Përpara mbarimit të afatit të vlefshmërisë, institucioni publik, në raste te veçanta, mund t'i kërkojë me shkrim ofertuesve të zgjasin afatin e vlefshmërisë. Ofertuesit që refuzon kërkesën nuk e humbet sigurimin i ofertes. Ofertuesi që e pranon kërkesën nuk do t'i kërkohej ose lejohet të tërheqë oferten e tij gjatë periudhës së zgjatjes së vlefshmërisë, pa humbur më parë sigurimin e ofertes.
3. Gjate kësaj periudhe nuk lejohet absolutisht modifikimi i ofertave.

12. Sigurimi i ofertës

1. Kërkesat për shumën dhe formën e sigurimit të ofertes tregohen në Të Dhenat e Ofertes.
2. Sigurimi i ofertes duhet të paraqitet me oferten dhe ka për qëllim të

dekurajoje ofertuesit e papërgjegjshëm.

3. Me përjashtim të rastit kur konfiskohet sigurimi i ofertes, ajo do t'i kthehet ofertuesit që e ka depozituar atë brenda 5 ditëve nga dita që ka hyrë kontrata në fuqi ose më parë, kur te gjitha ofertat refuzohen, kur procedura e konkurrimit anulohet, kur ofertuesi skualifikohet ose oferta është refuzuar.
4. Sigurimi i ofertes do të konfiskohet nga institucioni publik në se ofertuesi tërheq ofertën e tij brenda periudhës së vlefshmërisë.
5. Sigurimi i Ofertes do të konfiskohet në se oferta refuzohet për veprime të paligjshme të përshkruara në Klauzolën e mësipërme të udhëzimeve.
6. Sigurimi i Ofertes do të konfiskohet në se ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik në ofertën e tij të zbuluar gjatë shqyrtimit të ofertes.
7. Ofertuesit fitues do të konfiskohet sigurimi i ofertes në se ofertuesi heq dorë nga lidhja e kontratës ose nuk është në gjendje të japë sigurimin e përmbushjes së detyrimeve të kontratës, në qoftë se do të kërkohej një sigurim i tillë.
13. **Formati dhe nënshkrimi i ofertës**
 1. Ofertuesi duhet të paraqesë vetëm një zarf me dokumentat origjinale ose kopje të noterizuara të tyre, për të marrë pjesë në konkurrimin publik të restaurimit të monumenteve të kulturës.
 2. Oferta duhet të nënshkruhet nga ofertuesi ose nga një person i autorizuar për të firmosur në emër të ofertuesit. Prova e autorizimit konsiston në autorizimin me shkrim dhe i bashkëngjitet ofertes.
 3. Të gjitha faqet e Ofertes, duhet të nënshkruhen ose inicializohen nga personi që firmos ofertën.
 4. Çdo kryqëzim, fshirje, mbishkrim do të jetë i vlefshëm vetëm në se firmoset ose inicializohet nga personi që firmos ofertën.
14. **Paraqitja dhe hapja e ofertave**
 1. Ofertuesit duhet të dërgojnë ofertat e tyre në afatin , vendin, dhe mënyrën e dërgimit të shprehur në njoftimin publik të ftesës për oferte Të Dhënat e Ofertes.
 2. Ofertat e marra në një datë ose orë më të vonë se ajo e specifikuar do të refuzohen dhe kthehen ofertuesit të pahapura.
 3. Institucioni publik përpara mbarimit të afatit për paraqitjen e ofertes, mund të zgjasë afatin e paraqitjes të ofertave. Çdo zgjatje e tillë do t'i komunikohet menjëherë me shkrim kandidatëve që kanë blerë dokumentat e restaurimit.
 4. Vetëm një oferte mund të paraqitet nga çdo ofertues.
 5. Asnjë ofertues nuk mund të marrë pjesë në ofertën e dikujt tjetër për të njëjtën kontratë në çfarëdo lloji kapaciteti. Pjesëmarrja nga një ofertues në më shumë se një oferte, tek për tek ose me një ofertues tjetër, do të rezultojë në përjashtimin nga procesi i të gjithë ofertave në të cilat është i përfshirë ofertuesi.
15. **Vulosja dhe Shënimi i Zarfave**
 1. Oferta do të futet në një zarf të madh të vulosur, firmosur dhe mbyllur

nga ofertuesi.

2. Brenda tij në një zarf më vetë dhe të mbyllur, futet oferta ekonomike e firmosur dhe vulosur.
3. Mënyra e paraqitjes së tyre, mbishkrimet e duhura përcaktohen në Të dhënat për Restaurim, ku të evidentohet gjithashtu shënimi "Të mos hapet para sesionit të hapjes së ofertes."
4. Nuk aplikohet zarf tjetër me dokumenta "Kopje."

16. Hapja e ofertave

1. Institucioni publik do të hapë të gjitha ofertat në datën dhe orën e përcaktuar në Dokumentat e Restaurimit për hapjen e ofertave.
2. Ofertuesit ose përfaqësuesit e tyre të autorizuar do të lejohen të ndjekin hapjen e ofertave.
3. Ofertat do të hapen dhe informacioni i mëposhtëm duhet të njoftohet dhe regjistrohet:
 - Emri i ofertuesit
 - Shuma totale e ofertes
 - Prezenca ose mungesa e sigurimit të ofertes
 - Terheqja ose modifikimi i ofertave (nëse është bërë)
4. Do të mbahet procesverbali dhe në bazë të kërkesës çdo ofertuesi duhet të vihet në dispozicion një kopje e këtij procesverbali.

17. Vlerësimi dhe krahasimi i ofertave

Vlerësimi dhe krahasimi i ofertave do të bëhet pas kualifikimit ligjor dhe në bazë të kriterëve të vlerësimit, sic përcaktohet në dokumentat standarte të restaurimit.

a. Konfidencialiteti

1. Pas hapjes së ofertes, informacioni që ka të bëjë me egzaminimin, sqarimin dhe vlerësimin e ofertave dhe rekomandimet për fituesin nuk duhet t'i transmetohen ofertuesve ose personave të tjerë që nuk kanë lidhje zyrtare me procesin deri kur fituesi i kontratës të shpallet.
2. Pas hapjes së ofertes dhe deri sa të firmoset kontrata, asnjë ofertues nuk duhet të komunikojë pa kërkesë me shkrim, me institucionin publik ose të përpiqet në ndonjë mënyrë të influencojë egzaminimin dhe vlerësimin e ofertave nga komisioni.
3. Çdo përpjekje nga ofertuesi për të influencuar komisionin e konkurrimit në vendimin mbi vlerësimin e ofertes, krahasimin e ofertes, ose dhënien e kontratës mund të rezultojë në refuzimin e ofertes së atij ofertuesi.

19. Shqyrtimi paraprak i ofertave

Institucioni publik do të shqyrtojë çdo oferte për të konfirmuar se të gjitha dokumentat dhe dokumentacioni i kërkuar në dokumentat e restaurimit është siguruar dhe për të përcaktuar plotshmërinë e çdo dokumenti të paraqitur. Nëse ndonjë prej dokumentave të kërkuar mungon ose është i paplotë, oferta do të refuzohet.

20. Egzaminimi i afateve e kushteve dhe vlerësimi teknik i ofertave

- a. Institucioni publik do të shqyrtojë çdo oferte për të konfirmuar se ajo

është konform ndaj të gjitha kërkesave të percaktuara në dokumentat e restaurimit dhe se i permbush të gjitha afatet dhe kushtet. Oferta që është konform ndaj të gjitha kërkesave duke përfshirë afatet dhe kushtet konsiderohet e vlefshme.

- b. Oferta është e vlefshme edhe në se përmban devijime të vogla që nuk alternojnë materialisht ose dalin jashtë karakteristikave, afateve, kushteve dhe kërkesave të tjera të paraqitura në dokumentat e restaurimit.
- c. Çdo devijim i vogël do të matet në madhësinë e mundshme, dhe do të merret parasysh sic duhet në vlerësimin dhe krahasimin e ofertave.
- d. Oferta që nuk është e vlefshme do të refuzohet

21. Shpjegimi dhe Korrigjimi i Gabimeve Aritmetike dhe Formaliteteve të Vogla

- a. Komisioni i konkurrimit t mund t'i kërkojë një ofertuesi të sigurojë shpjegime me shkrim për ndonjë pjesë të Ofertes të tij. Kërkesa të tilla do të bëhen vetëm për qëllime sqarimi. Nuk mund të kërkohet, ofrohet ose lejohet asnjë ndryshim në çmim ose në substancën e Ofertes përveçse korrigjimit të gabimeve aritmetike.
- b. Në se ofertuesi dështon në sigurimin e shpjegimeve të shkruara brenda 7 ditësh nga marrja e kërkesës së institucionit publik, oferta e paraqitur nga ai ofertues mund të refuzohet.
- c. Gabimet aritmetike do të ndreqen në mënyrën e mëposhtme. Nëse ka ndonjë mospërputhje midis çmimit për njësi dhe çmimit total që del nga shumëzimi i çmimit të njësi me sasinë, çmimi i njësi do të mbizotërojë dhe çmimi total do të korrigjohet në bazë të tij. Nëse ka ndonjë mospërputhje midis fjalëve dhe shifrave, shumën në fjalë do mbizotërojë. Nëse ofertuesi nuk pranon korrigjimin e gabimeve, oferta e tij do të refuzohet dhe sigurimi i ofertes do të konfiskohet.

22. Vlerësimi dhe krahasimi i ofertave

- a. Institucioni publik do të vlerësojë dhe krahasojë ofertat që janë kualifikuar si të vlefshme me qëllim që të përcaktojë ofertën fituese në përputhje me procedurat dhe kriterin e paraqitur në dokumentat e restaurimit. Asnjë kriter nuk do të përdoret në qoftë se nuk është parashikuar në dokumentat e restaurimit.
- b. Oferta e suksesshme do të jetë oferta e vlefshme që fiton më shumë pikë sipas metodologjisë së përcaktuar në dokumentat standarde të restaurimit.
- c. Në rastin kur rezultati përfundimtar me pikë rezulton i barabartë për më shumë se një ofertë, përzgjedhja e fituesit do të bëhet nga njësia e vlerësimit e cila vendos me shumicë votash për ofertën më të mirë ekonomike, me vendim të argumentuar, mbështetur në kriteret e vlerësimit të përmendura në dokumentet standarde.

23. Konfirmimi i Kualifikimeve të Ofertuesit Fitues

- a. Përpara se të shpallet fituesi, institucioni publik do të përcaktojë se ofertuesi që ka paraqitur ofertën fituese sipas tij është i aftë të zbatojë kontratën e konkurrimit në mënyrë të kënaqshme.

- b. Përcaktimi do të bazohet mbi një egzaminim të informacionit të paraqitur nga ofertuesi me oferten e tij, të provave të dokumentuara të paraqitura nga ofertuesi dhe çdo informacion tjetër i grumbulluar nga institucioni publik. Megjithatë, faktorët e papërfshirë në kërkesat e kualifikimit të paraqitura në dokumentat e restaurimit nuk do të përdoren në vlerësimin e kualifikimeve të ofertuesit.
- c. Përcaktimi se një ofertues është i kualifikuar do të jetë kusht për fitim. Në rast se oferta e klasifikuar e para me pikë nuk pranon të lidhë kontratën, institucioni publik do të procedojë tek oferta e radhës për të vendosur mbi aftësinë e ofertuesit për të zbatuar kontratën e konkurrencës në mënyrë të kënaqshme.

24. Refuzimi i të Gjitha Ofertave

- a. Institucioni publik rezervon të drejtën për të refuzuar të gjitha ofertat në çdo kohë para pranimit të tyre.
- b. Lajmërimi për refuzim do t'i jepet menjëherë çdo kandidati pjesëmarrës.
- c. Institucioni publik nuk do të ketë asnjë përgjegjësi ndaj kandidatëve që kanë paraqitur oferta.

25. Ofertuesi Fitues

- a. Ofertuesi Fitues është ofertuesi oferta e të cilit plotëson të gjitha afatet, kushtet dhe kërkesat teknike të paraqitura në dokumentat e restaurimit dhe që është përcaktuar si fitues në bazë të kriterit të vlerësimit të paraqitur në dokumentat e restaurimit nëse ofertuesi është përcaktuar gjithashtu si i kualifikuar të zbatojë kontratën.

26. Shpallja e fituesit dhe nënshkrimi i kontratës

- a. Institucioni publik do të njoftojë ofertuesin Fitues se oferta e tij është pranuar.
- b. Lajmërimi do të përmbajë të paktën vlerën totale të kontratës, kërkesën për dhënien e sigurimit të kontratës.
- c. Njoftimi i fituesit do të përbëjë hartimin e kontratës.
- d. Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me anë të nënshkrimit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve dhe duhet të firmoset nga ofertuesi Fitues brenda afatit të përcaktuar të ditëve nga marrja e lajmërimit të fitimit.
- e. Nëse ofertuesi Fitues nuk e pranon kontratën, ofertuesit i konfiskohet sigurimi i ofertes.
- f. Nëse ofertuesi fitues, brenda afatit kohor të përcaktuar në dokumentat e restaurimit, nuk nënshkruan kontratën ose nuk ben sigurimin e kontratës, institucioni publik ben konfiskimin e sigurimit të ofertes, atëherë do të shpallet si fitues pjesëmarrësi i renditur i dyti në klasifikim.

27. Sigurimi i kontratës

- a. Institucioni publik do të kërkojë dhënien e sigurimit të kontratës nga ofertuesi Fitues në shumën dhe formën e parashikuar në dokumentat e restaurimit.
- b. Ofertuesi Fitues duhet të japë garancinë e sigurimit të kontratës brenda

afatit të përcaktuar në njoftimin e fituesit

- c. Në se ofertuesi Fitues dështon në dhënien e sigurimit të kontratës brenda afatit, ofertuesi humbet të drejtën e tij për të nënshkruar kontratën dhe i konfiskohet siguri i ofertes.

28. Llogaritja e limiteve kohore

- a. Të gjitha referencat për ditët do të jenë ditë kalendarike me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe.
- b. Periudhat dhe limitet kohore do të fillojnë të numërohen nga fillimi i ditës pas datës së aktit ose veprimit që shërben si pikë nisje për periudhat ose limitet kohore.
- c. Aty ku një periudhë ose limit kohor shprehet në ditë, ai do të skadojë në fund të ditës së fundit të periudhës ose limitit kohor.
- d. Aty ku dita e fundit e një periudhe ose limiti kohe bie në ditë feste në Republikën e Shqipërisë, periudha ose limiti kohor do të zgjatet deri në fund të ditës tjetër të punës.

29. Shqyrtimi administrativ

- a. Ofertuesi ka të drejtë të kërkojë shqyrtim administrativ të një veprimi ose neglizhence nga institucioni publik, të cilin ofertuesi e konsideron një shkelje të dispozitave të Konkurrimit Publik për restaurimet, ose të Rregullave apo dhe çdo udhezimi të lëshuar për to. Paraqitja e ankesës tek titullari i institucionit publik ose tek Titullari I Ministrisë, pezullon shpalljen e fituesit dhe lidhjen e kontratës deri në kthimin e përgjigjes sipas kompetencave dhe afateve të parashikuara në Të dhënat e Restaurimit.
- b. Pasi institucioni publik të ketë nënshkruar kontratën me ofertuesin Fitues, asnjë ankesë ndaj një veprimi ose neglizhence në proces që ka çuar në atë fazë nuk mund të shqyrtohet me anë të një shqyrtimi administrativ.
- c. Procedurat dhe afatet e ankimit përcaktohen në VKM “Për konkurrimin publik për restaurimet”.